



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 13 (827711)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 26 Mars 2021

Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e Mjekësisë Ushtarake



Nënskruhet marrëveshja për trajtimin mjekësor të ushtarakëve shqiptarë në Turqi

Më 24 mars 2021, u nënskruhet në Ministrinë e Mbrojtjes të Shqipërisë "Protokolli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për bashkëpunimin në fushën e Mjekësisë Ushtarake". Protokolli u nënskrua nga zoti Florian Kali, drejtor i Përgjithshëm i

Politikave të Mbrojtjes dhe kolonel Muhammet Kelami Kablay, atashe ushtarak i Turqisë në Tiranë. Procesi u finalizua pas një periudhe intensive negociimi. Kjo marrëveshje i vjen në ndihmë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë pasi pala turke merr përsipër kurimin... » faqe 4

Ambasadores e SHBA Yuri Kim

Misioni ynë nuk ka përfunduar, ruani nivelet më të larta të bashkëpunimit



» faqe 3

Modernizimi i Forcave të Armatosura

SHBA dhurojnë 29 mjete të blinduara "Humvee" për Batalionin II të Këmbësorisë

Ambasadorja e SHBA Yuri Kim: Dhurimi i 29 mjeteve të reja, është si një donacion i rëndësishëm në prag të "Defender Europe 21", stërvitjes ushtarake më të madhe në Evropën Juglindore » faqe 3



Ceremonia

I jepet lamtumira e fundit gjeneral brigade Ndrichim Sallakut

Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes dhe duke respektuar masat anti-COVID, paradite më 22 mars 2021, u zhvilluan homazhe për ndarjen nga jeta para kohe, të komandantit të Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ndrichim Sallaku. Për t'i dhënë lamtumirën e fundit gjeneral Sallakut, në homazhe ishin të pranishëm presidenti i Republikës Ilir Meta, ministri i...



» faqe 2

Në Komandën e Forcës Ajrore

Zhvillohet Konferenca Fillestare e Planëzimit "Ambicia e Shqiponjës"

Në Komandën e Forcës Ajrore u zhvillua më 19 mars 2021, Konferenca Fillestare e Planëzimit "Ambicia e Shqiponjës" me pjesëmarrjen e shtabit të Forcës Ajrore, personelit të Qendrës së Kontroll-Raportimit, si dhe përfaqësues të Bazës Ajrore Farkë. Shefi i Shtabit të Forcës Ajrore, kolonel Arben Cenolli në fjalën e tij...

» faqe 8

Bruksel: Takimi i ministrave të Jashtëm të NATO-s

NATO hedh bazat për Samitin e ardhshëm të Aleancës

» faqe 10

"LIGJI PËR KARRIERËN USHTARAKE NË FA

Ministri Peleshi: Ligji garanton rekrutime të sigurt si për ushtarët ashtu edhe për oficerët

» faqe 4

ARKIVI QENDROR I FA

Hapen dokumentet arkivore për Luftën e Dytë Botërore dhe Luftën e Ftohtë

» faqe 6-7



Më datë 20 mars 2021, është ndarë nga jeta, nga sëmundja e rëndë e shkaktuar nga COVID-19, me gjithë kujdesin shëndetësor, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ndriçim Sallaku. Forcat e Armatosura kanë humbur me gjeneral brigade Sallakun, ushtarakun kurajoz, liderin e spikatur, profesionistin e shkëlqyer dhe njeriun e përkushtuar, ndërsa familja babain, bashkëshortin, gjyshin, familjarin e shtrenjtë. Lutemi për forcë për të përballuar këtë situatë të vështirë në jetën e tyre.

Gjeneral Brigade Ndriçim Sallaku lindi më 14 qershor 1966 në Durrës. Gjeneral brigade Sallaku filloi karrierën ushtarake në vitin 1987, në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficereve dhe ka shërbyer me devotshmëri për 34 vjet në Forcat e Armatosura, kryesisht në degën e Logjistikës në të gjitha nivelet e komandimet. Karriera e tij në Forcat e Armatosura kulmoi me marrjen e gradës gjeneral brigade në vitin 2019, me dekret të presidentit të Republikës nr. 11077, dhe prej asaj date vijonte të kryente detyrën e komandantit të Komandës Mbështetëse.

Gjeneral brigade Sallaku ka shërbyer në një numër misionesh ndërkombëtare dhe është vlerësuar me medalje nga OKB dhe BE, për kontributin e tij në Misionin Paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara në Gjeorgji (UNOMIG) (2008-2009) dhe detyrën si zëvendësues për operacionet në misionin e BE-së, ALTHEA në Bosnje dhe Hercegovinë (2010-2011). Ai ka shërbyer si atashe ushtarak i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në Republikën e Turqisë, jo rezident në Republikën e

Komandanti i Komandës Mbështetëse

Ndërron jetë gjeneral brigade Ndriçim Sallaku



Izraelit, Gjeorgjisë dhe Azerbajxhanit (2017-2019), gjeneral brigade Sallaku dha një kontribut të shtuar në projektet modernizuese të FA-së, nëpërmjet granteve të dhëna nga Forcat e Armatosura të Turqisë dhe koordinimit për kontingjentet e përbashkëta me Turqinë për misionet ushtarake në Afganistan.

Gjeneral brigade Sallaku ka qenë një ndër ekspertët më të spikatur në fushën e logjistikës në Forcat e Armatosura. Kontributi i tij në përmbytjen e standardeve të NATO-s në fushën e Logjistikës, bazohej në ekspertizën e fituar nga pjesëmarrja në një numër trajnimesh në fushën e logjistikës dhe mbrojtjes në Turqi, Francë, Gjermani.

Ndjekja dhe përfundimi me rezultate të larta i Akademisë së Luftës dhe Kolegjit të Lartë për Sigurinë në Turqi, e përgatitën atë si drejtues dhe për të marrë detyra të nivelit strategjik, të cilat ai i realizoi me sukses deri në ditët e fundit para infektimit me COVID-19. Gjeneral brigade Ndriçim Sallaku po kurohej nga COVID-19, në një prej spitaleve në Turqi edhe nën kujdesin e Forcave të Armatosura të Turqisë. Falënderojmë Shtabin e Përgjithshëm dhe Ministrinë e Mbrojtjes së Turqisë për kujdesin ndaj gjeneral brigade Ndriçim Sallakut, por edhe shumë ushtarakeve të Forcave të Armatosura të RSH-së ndër vite.

Meta i akordon Dekoraten "Nderi i Kombit" gjeneral brigade Ndriçim Sallakut

Presidenti Ilir Meta i ka akorduar Dekoraten e lartë "Nderi i Kombit", gjeneralit që humbi betejën nga COVID-i në moshën 55-vjeçare, Ndriçim Sallakut. Në postimin e publikuar në rrjetet sociale, Meta thekson se dekorata i është dhënë në mirënjohje për vlerat e larta atdhetare e njerëzore, që zoti Sallaku shpalosi gjatë veprimtarisë së tij akademike e shkencore. Gjithashtu Presidenti e etiketoi gjeneralin e ndërjet si një ushtarak model e i shkëlqyer në karrierë. Në njoftimin e plotë të Presidentit Ilir Meta thuhet: "Në vlerësim të veprës së çmuar e të gjithanshme, si një ushtarak model dhe i shkëlqyer karriere, për modernizimin e Forcave të Armatosura shqiptare dhe me mirënjohje shtetërore për vlerat atdhetare e njerëzore, që shpalosi gjatë veprimtarisë së tij akademike dhe shkencore, si dhe ndaj kontributit të qenësishëm në zhvillimin, lartësimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të ushtarakëve tanë në uniformë, duke u shërbyer me dinjitet dhe krenari demokracisë e vlerave të paqes në radhët e Aleancës së NATO-s, pata privilegjin t'i akordoj sot Dekoraten e lartë "Nderi i Kombit", Gjeneral Brigade Ndriçim Sallakut. I paharruar kujtimi i Tij dhe vepra e ndritur, që i la trashëgim Forcave tona të Armatosura!"



Peleshi: Fitoi çdo sfidë, humbi betejën me COVID-19

Ndërkohë, ministri i Mbrojtjes i ka kushtuar një postim në rrjetet sociale ngjarjes. "Nuk kam fjalë për ndarjen e papritur nga jeta të komandantit të Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ndriçim Sallaku. Në kaq pak kohë në krye të Ministrisë së Mbrojtjes, Gjeneral Sallaku u bë një ndër bashkëpunëtorët më të spikatur, me një sens të jashtëzakonshëm ndjeshmërie për komunitetin, të cilën e tregoi edhe gjatë përmbytjeve të fundit në Nënshkodër dhe Katund të Ri. Gjeneral Sallaku fitoi çdo sfidë ku shërbeu në Forcat e Armatosura, por fatkeqësisht humbi betejën me COVID-19. Do të kujtojmë përgjithmonë Gjeneralin!" Ndërkohë edhe Ministri i Jashtme, Olta Xhaçka ka reaguar për ndarjen nga jeta, prej COVID-19, të gjeneralit të brigadës, Ndriçim Sallaku. Xhaçka shkruan se: "Njerëzit si ti gjeneral Sallaku, janë të rrallë: energjikë, të kudogjendur, pozitivë përballë çdo situatë. Na dhemb të gjithëve humbja jote sot, Majlindës e fëmijëve të shtrenjtë, ne që patëm fatin të ndajmë me ty ditë, muaj e vite pune, të vështira apo të bukura. Do mungosh në



Komandën Mbështetëse dhe të gjithë Forcën e Armatosur, me korrektesinë e përgjegjshmërinë tënde e mbi të gjitha me përkushtimin ndaj

njerëzve e jetës. Mirënjohëse për shërbimin gjeneral! Faleminderit për modelin e ushtarakut të mirë e të drejtë", shkruan Xhaçka.

I jepet lamtumira e fundit gjeneral brigade Ndriçim Sallakut

Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes dhe duke respektuar masat anti-COVID, paradite më 22 mars 2021, u zhvilluan homazhe për ndarjen nga jeta para kohe, të komandantit të Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ndriçim Sallaku. Për t'i dhënë lamtumirën e fundit gjeneral Sallakut, në homazhe ishin të pranishëm presidenti i Republikës Ilir Meta, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, ministri për Evropën dhe Punët Jashtme Olta Xhaçka, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj, ambasadorja e SHBA Yuri Kim, ambasadori i Republikës së Turqisë Murat Ahmet Yörük, ish-ministria e Mbrojtjes Mimi Kodheli, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë, gjeneralë dhe komandantë forcash, familjarët e të ndjerit, miq e dashamirës, etj. Pas kryerjes së homazheve, ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, vlerësoi punën dhe përkushtimin në gjithë karrierën e tij ushtarake veçanërisht kontributin e tij në Emergjencat Civile.

Modernizimi i Forcave të Armatosura

SHBA dhurojnë 29 mjete të blinduara
"Humvee" për Batalionin II të Këmbësorisë

Ambasadorja e SHBA, Yuri Kim: Dhurimi i 29 mjeteve të reja, është si një donacion i rëndësishëm në prag të "Defender Europe 21", stërvitjes ushtarake më të madhe në Europën Juglindore



itetet tona janë kapacitetet tuaja, janë kapacitetet e aleancës, FA shqiptare do të jenë gjithmonë me ju gjithmonë me aleancën në mbrojtjen dhe sigurimin e vlerave tona të përbashkëta.", iu drejtua ministri Peleshi ambasadores së SHBA, Yuri Kim.

Nga ana e saj, ambasadorja Kim tha se dhurimi i mjeteve të reja kontribuon në transformimin e Batalionit II të Këmbësorisë, nga një batalion i lehtë, në një batalion të mekanizuar. Diplomati amerikane u shpreh krenare që Shqipëria i përgjigjet detyrës, duke qenë gjithmonë në krah të SHBA, pavarësisht sa të rrezikshme janë misionet, pavarësisht sa larg shtëpisë. Dhurimin e 29 mjeteve të reja, ajo e konsideroi si një donacion të rëndësishëm në prag të "Defender Europe 21", stërvitjes ushtarake më të madhe në Evropën Juglindore. Mjetet e reja të dhuruara nga SHBA do të përdoren kryesisht nga Batalioni II i Këmbësorisë në Forcën Tokësore, i cili është një strukturë në gatishmëri dhe dispozicion të Aleancës për t'u dislokuar kudo dhe kurdo.

Në ceremoninë e zhvilluar në Zall Herr, u cilësua se Batalioni II i Këmbësorisë së Forcës Tokësore (b2k) është një hap më pranë mekanizimit të plotë të tij. Qeveria e SHBA dhuroi 29 mjete të reja, të blinduara, shumëpërdorimshme dhe me lëvizshmëri të lartë (Humvee) për këtë strukturë të deklaruar në NATO.

Ministri Peleshi, ditën e mërkurë, më 24 mars 2021, përshëndeti SHBA për ndihmën e vazhdueshme që ka dhënë për modernizimin e FA, trajnimin dhe arsimimin e efektivëve tanë. "Ndihma materiale, teknike dhe modernizuese e SHBA, i ka dhënë dhe u jep ushtarakëve tanë më shumë fuqi, forcë dhe efektivitet në operacionet brenda dhe jashtë vendit. Në sajë të kësaj ndihme, ata janë më të trajnuar për të përmbushur me sukses pothuajse të gjithë spektrin e misionëve dhe detyrave. Kjo mbështetje e vazhdueshme e fuqishme dhe thelbësore ju ka dhënë veçanërisht trupave tanë të angazhuar jashtë vendit më shumë besim, siguri dhe dinjitet në krye të detyrave të tyre. Modernizimi i teknikës dhe i pajisjeve duke filluar me mjete komunikimi detare, ajrore, mjete të blinduara dhe pajisje të tjera luftarake tokësore, mjete të mbrojtjes kimike e të tjera, ka qenë domethënëse për FA. 29 mjete të blinduara dhe armatimi luftarak për të cilat jemi mbledhur sot në këtë event sigurojnë që nuk janë dhe nuk do të jenë të fundit. Kjo ndihmë dhe mbështetje për forcimin e muskujve ushtarakë të dy prej njësisë tona kryesore siç janë batalioni i II dhe ai i Forcave Speciale është shumë më tepër se kontributi real dhe konkret rritjen e kapaciteteve të tyre operacionale luftarake. Kapac-

AMBASADORES E SHBA YURI KIM

Misioni ynë nuk ka përfunduar, ruani nivelet më të larta të bashkëpunimit

Fjalimi i Ambasadores Yuri Kim mbajtur më 24 mars 2021, në ceremoninë për Dhurimin e Mjeteve Humvee për Forcat e Armatosura Shqiptare

Mirëmëngjes Ministër Peleshi, Gjeneral Begaj dhe të ftuar të nderuar. Do të doja të falënderoja veçanërisht mikpritësin tonë, Gjeneral Kingjin, për mirëpritjen time në Zall Herr-shtëpinë e Forcave Tokësore Shqiptare. E sotmja nuk është thjesht një mundësi për të kryer një ceremoni, por një mundësi për të takuar komandantin e ri të forcës tokësore të Shqipërisë. Gjeneral, ju përgëzoj për marrjen e këtij roli të rëndësishëm.

Jemi këtu për të festuar dorëzimin e 29 Automjeteve Ushtarake të Lëvizshmërisë së Lartë, ose "Humvee", për Forcat e Armatosura Shqiptare. Këto automjete të reja do të përmirësojnë menjëherë aftësitë e forcave tokësore shqiptare në një moment kritik. Ky gur kilometrazhi i fundit është pjesë e një projekti parësor për Shtetet e Bashkuara-për të ndihmuar në tranzicionin e batalionit të dytë të këmbësorisë së Shqipërisë nga një Grup-Beteje i Këmbësorisë së Lehtë në një Grup-Beteje i Këmbësorisë i Motorizuar.

Angazhimi i Shqipërisë për të përgatitur një Grup-Beteje të Këmbësorisë së Motorizuar për NATO-n është domethënëse. Ai përforcon rëndësinë e angazhimeve të NATO-s dhe na kujton se Shqipëria është e gatshme të veprojë në vende të rrezikshme

përkrah aleatëve. Pasi të përfundojë, ky projekt do të përmirësojë aftësinë e Shqipërisë për të kryer misione të brendshme mbrojtëse dhe për të zbarkuar në mbështetje të operacio-

neve globale. Shtetet e Bashkuara mbeten mirënjohëse që Shqipëria i është përgjigjur thirrjes në vende të ndryshme nëpër botë.

Ky dhurim është gjithashtu ven-

dimtar, sepse jemi në përgatitjet e fundit për një ngjarje historike -Stërvitja "Defender 21". "Defender 21" është një stërvitje ushtarake shumëkombëshe, e cila do të ndodhë

në Shqipëri këtë verë dhe Shqipëria është zgjedhur për të mikpritur një aspekt të rëndësishëm të stërvitjes. Kjo do të jetë stërvitja më e madhe ushtarake ndonjëherë në Evropën Juglindore dhe sigurojë do të tregojë rëndësinë e Shqipërisë në rajon. Në mënyrë të veçantë, presim me kënaqësi t'i shohim këto automjete të marrin pjesë në këtë ngjarje premierë trajnimi. Dua të falënderoj Ministrin Peleshi dhe Gjeneral Begajn për udhëheqjen e tyre të jashtëzakonshme dhe dua të falënderoj stafin e Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes për punën e tyre të vështirë në realizimin e kësaj. Misioni ynë nuk ka përfunduar ende dhe ju bëj thirrje që të ruani nivelet më të larta të bashkëpunimit.

Është me të vërtetë një kohë emocionuese të jesh ushtar në Forcat e Armatosura të Shqipërisë ose ushtar amerikan që shërben në Shqipëri. Ne jemi të nderuar të qëndrojmë krah për krah me ju dhe të shohim përpara për rritjen e bashkëpunimit ushtarak në muajt në vijim.



Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e Mjekësisë Ushtarake

Nënshkruhet marrëveshja për trajtimin
mjekësor të ushtarakëve shqiptarë në Turqi*Protokolli u nënshkrua nga zoti Florian Kali, drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Mbrojtjes dhe kolonel Muhammet Kelami Kablay, atashe ushtarak i Turqisë në Tiranë*

Më 24 mars 2021, u nënshkruhet në Ministrinë e Mbrojtjes të Shqipërisë "Protokolli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për bashkëpunimin në fushën e Mjekësisë Ushtarake".

Protokolli u nënshkrua nga zoti Florian Kali, drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Mbrojtjes dhe kolonel Muhammet Kelami Kablay, atashe ushtarak i Turqisë në Tiranë.

Procesi u finalizua pas një periudhe intensive negocimi. Kjo marrëveshje i vjen në ndihmë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë pasi pala turke merr përsipër kurimin falas në institucionet mjekësore ushtarake të anëtarëve aktivë në detyrë të Forcave të Armatosura dhe familjarëve të tyre, personelit në rezervë dhe pension të Forcave të Armatosura dhe personelit civil që punon në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Protokolli rregullon trajtimin e studentëve ushtarakë shqiptarë, të cilët studiojnë për mjekësi në Turqi, me bursa falas, si dhe parashikon kurse dhe specializime për rritjen e tyre profesionale. Palët angazhohen për implementimin sa më parë të këtij protokoll.



"Ligji për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura"

Kjo marrëveshje i vjen në ndihmë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë pasi pala turke merr përsipër kurimin falas në institucionet mjekësore ushtarake të anëtarëve aktivë në detyrë të Forcave të Armatosura dhe familjarëve të tyre, personelit në rezervë dhe pension të Forcave të Armatosura

Ministri Peleshi: Ligji garanton
rekrutime të sigurt si për
ushtarët ashtu edhe për oficerët*Konsultimi publik "Ligji për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura" ka marrë në konsideratë propozimet e bëra nga grupi këshillues amerikan*

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi deklaroi më 16 mars, në seancën parlamentare se ndër risitë që sjell Ligji për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura është garantimi i rekrutimeve të sigurt si për trupën e ushtarëve ashtu edhe për oficerët.

Gjatë fjalës së tij në Kuvend, ku u shqyrtua Dekreti i Presidentit të Republikës, për kthimin e ligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", Peleshi tha se ligji për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura ka si objekt përcaktimin e normave dhe të rregullave të hollesishme të rekrutimit, përparimit në karrierë, dhe lirim të ose daljes në rezervë të ushtarakëve.

"Ligji aktual në fuqi, -shtoi Peleshi, -në krahasim me ligjin e mëparshëm mundësoi gjatë këtyre 7 viteve, largimin e të rekrutuarve jashtë karriere, rritjen e kohës së qëndrimit të FA-ve të gradave të larta, duke i afuar ndjeshëm me moshën e pensionit. Uljen e kostove të trajtimit të personelit që paguhet me pension të parakohshëm dhe me pagesë kalimtare, përfshirjen e nën/officerëve në sistemin e vlerësimit në Komisionet e karrierës ku shqyrtohen dhe trajtohen nënofficerët". "Gjatë implementimit të ligjit në këto 7 vite, përveç anëve pozitive të shumta që solli për FA-në, janë identifikuar edhe disa problematika, të cilat nevojitet të adresohen për të garantuar në të ardhmen një sistem të sigurt rekrutimi, rritje të performancës së personelit ushtarak dhe garantimin e karrierës së tyre në

FA", -u shpreh Peleshi.

Ai nënvizoi se risitë që sjell ndryshimi i këtij ligji janë: "Garantimi i rekrutimeve të sigurt si për trupën e ushtarëve ashtu edhe për oficerët; Trajtimin dinjitoz të studentëve ushtarakë që zgjedhin për të studiuar dhe

më pas për të shërbyer në FA; Rritjen e konkurrencës për të përzgjedhur më të mirët për nën/officerë aktivë nga personeli i ushtarëve në FA; Kushte e kritere të njëjta për të gjithë personelin ushtarak nën/officer dhe oficer në FA; Garantimi i përfitimit të trajtimit sipas

statusit të ushtarakut edhe për gradat e ulëta; Mbështetjen e personelit me specialitete të veçanta në FA, për të cilët është konstatuar vështirësi në rekrutim dhe në trajtimin e tyre; Plotësimin e nevojave për ushtarë dhe në ato reparte ku kemi vështirësi për rekrutimin e tyre; Zgjidhjen e problematikës së ushtarakëve ndër vite, që për arsyë të ndryshme nuk kanë një urdhër lirimi nga FA; Rritja e pagave, rritja e trajtimit financiar sipas vështirësive; Rifillimi i trajtimit të munguar të kompensimit të ushqimit; Fillimi i sistemit të ri arsimor bachelor në FA". "Mbështetja që u jep ushtarakëve ky ndryshim ligji dhe mbështetja që do të vijojë të shtohet vit pas viti për ushtarakët në FA do të krijojë një bazë të fuqishme profesionale në realizimin e detyrave si brenda ashtu dhe jashtë vendit dhe do t'i bëjë të ndihen më dinjitozë krah kolegëve të tyre në familjen e madhe të aleancës politiko-ushtarake NATO", -theksoi Peleshi. Lidhur me konsultimin publik, ministri Peleshi theksoi se: "Konsultimi publik për ligjin ka nisur më datë 25 mars 2019 dhe në mbledhjet e grupit të punës, krahas sugjerimeve nga

strukturat e brendshme, janë marrë në konsideratë edhe propozimet e bëra nga grupi këshillues amerikan. Eshtë vijuar me publikimin e draftit në regjistrin elektronik të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FA. Konsultimi publik është mbydhur në 30 shtator 2020. Kurse për disa specifitime arsimore, ai sqaroi se: "Rekrutimi i ushtarëve detarë/aktiv me arsim 9 vjeçar do të bëhet vetëm në raste të kufizuara përjashtimore dhe kur diktohet nga rrethanat të caktuara si: vendndodhja, rëndësia e repartit ushtarak apo kryerja e detyrave specifike komplekse të cilat nuk kanë nevojë për personel apo trajtim të avancuar". Ai tha se: "Veprimtaria e Forcave të Armatosura shfaq dinamika të reja e të vazhdueshme të cilat shoqërohen me ndryshime strukturore apo nevojiten për afrimin e specialiteteve të ndryshme. Ky ndryshim ka në thelb trajtimin e diferencuar të një kategorie ushtarakësh të cilët kanë specialitete të veçanta e që mund të kontribuojnë në mënyrë afatgjatë me dijet e tyre në fusha të veçanta nëveprimtarinë e Forcave të Armatosura. Emërimi në një funksion më të ulët organik i ushtarakut të Forcave të Armatosura bëhet për një periudhë deri në 1 vit dhe për çdo periudhë përtej këtij viti është i nevojshëm pëlqimi me shkrim paraprak i ushtarakut. Ky parashikim ka për qëllim plotësimin e përkohshëm të pozicioneve organike të cilat kryejnë detyra specifike dhe nuk mund të qëndrojnë vakante dhe është gjithashtu në përputhje me doktrinën ushtarake në të cilën parashikohet se: "ushtaraku kryen shërbimin e tij kudo ku paraqitet e nevojshme". Ndërkohëqë trajtimi financiar do të jetë sipas gradës", ka përfunduar Ministri Peleshi.



Marsi, muaji i figurës ushtarake femërore

Përgjegjësi operationale,
kombëtare dhe përfaqësim dinjitoz

Në ditët e para të marsit, kontigjentit shqiptar në misionin e KFOR-it në Kosovë, iu bashkuan edhe 5 gra dhe vajza nga Forcat e Armatosura shqiptare, ku 1 është civile




Nënkonele Alda SULA
Shtabi i Përgjithshëm i FA-së,
Shefe Shtabi e Grupimit të Përbashkët të Mbështetjes Logjistike të KFOR-it dhe Perfaqësues e Lartë Kombëtare Misioni i dytë

“Tashmë jo më një rrugë e pashkelur, jo më një mjedis i panjohur. Të njëjtat përgjegjësi e angazhime, por edhe kjo herë kishte sfidat e veta. Realizimi i detyrave në kushtet e pandemisë dhe me zgjidhje alternative”, na thotë nënkonele Alda SULA, që vjen nga Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, me detyrë në mision, Shef Shtabi i Grupimit të Përbashkët të Mbështetjes Logjistike të KFOR-it dhe Perfaqësues i Lartë Kombëtar.

Nënkonele Alda Sula është në këtë mision për herë të dytë. “Zbatimi i procedurave standarte të veprimit, ndjekja e një protokollit rigoroz me masat anti-Covid të KFOR-it, si dhe sinkronizimi i tyre me politikat kombëtare, ishin shqetësimi kryesor. Krahas përgjegjësi individuale, si përfaqësuese e Lartë kombëtare, mbizotëronte dhe përgjegjësi kolektive”. Alda thotë që gjeti një personel shumë të përgjegjshëm dhe koshient për detyrat e ndërmara, duke e parë veten në pozicion të favorshëm për të gjetur të gjithë mirëkuptimin e mundshëm, jo vetëm për të realizuar detyrën parësore nën autoritetin operacional të komandantit të KFOR-it, por dhe në drejtim të mbështetjes morale, psikologjike e sociale të kontigjentit shqiptar. Një element tjetër që Alda veçon është dhe fakti i rritjes së numrit të femrave në mision. Aktualisht, janë 5 ushtarake gra dhe vajza. Përveç Aldës,

të gjitha janë në mision për herë të parë. Detyrimi për mbështetje, këshillim e komunikim rritet. Është si një familje ku më i madhi ka përgjegjësinë e kujdesit ndaj më të vegjëlve, siç shprehet nënkonele Sula. Rritja e prezencës së ushtarakeve femra është aq inkurajues sa edhe ana psikologjike e morale për mbarëvajtjen e misionit. Kjo falë interesimit dhe politikave “gender” që ndjek lidhshipi ushtarak e civil i MM-së dhe SHP-së edhe për misionet.

Slogani/motoja tepër kuptimplotë e komandantit të KFOR-it, gjeneralmajor Franco Federici “AS ONE WE PROGRESS” sinkronizon efektshëm dy detyrat, përgjegjësi të operationale dhe ato kombëtare, për një përfaqësim dinjitoz dhe realizim të suksesshëm të misionit.



Majore Adelaida Shehu
Komanda Mbështetëse,
Officere për sigurinë në grupin mbështetës të KFOR-it
Misioni i parë

“Zbatimi i procedurave standarte të veprimit, ndjekja e një protokollit rigoroz me masat anti-Covid të KFOR-it, si dhe sinkronizimi i tyre me politikat kombëtare, ishin shqetësimi kryesor. Krahas përgjegjësi individuale, si përfaqësuese e Lartë kombëtare, mbizotëronte dhe përgjegjësi kolektive”

“E mora me entuziazëm faktin e pjesëmarrjes time në një mision paqeruajtës. Një eksperiencë e re, sfidë, dhe në pritshmëritë e mia, e parë si një shans pozitiv për ecuri në karrierë. Detyra që mbuloj është një detyrë që është kryer kryesisht nga meshkuj, duke bërë që në fillim ndoshta të ndihesha paksa e pasigurt, duke menduar vështirësitë me të cilat do të përballësja. Detyra kryesore e imja është të kryej detyra, si officer i sigurisë së kampit, duke planifikuar dhe koordinuar të gjitha masat e sigurisë me karakter mbrojtës për shtabin e KFOR-it. Por them se duhet vetëm predispozicion, seriozitet e përkushtim, që çdo gjë të ecë në rrugën e duhur. Janë këto cilësi që më ndihmuan që të ingranohesha shumë shpejt me detyrën dhe ambjentin përreth. Besoj se deri në fund të misionit kam për t’ia dalë me sukses, duke justifikuar përzgjedhjen time në këtë nision”, thotë majore Adelaida Shehu.



Kapitene Elisabeta Alcani
Akademia e Forcave të Armatosura,
Officer koordinativ për BCU, në Qendrën e Efekteve të KFOR-it
Misioni i parë

“Ndjem e privilegjuar që marr pjesë në një mision të tillë, siç është misioni i KFOR-it në Kosovë. Mendoj se çdo ushtarak duhet të ketë të përfshirë në CV e tij pjesëmarrjen në një mision, pasi e shoh shumë kuptimplotë.

Kisha dëgjuar nga kolegët e mi, që kanë shërbyer në këtë mision, dhe faktin e daljes së urdhërit për të ardhur në KFOR e mora me shumë ngazëllim, por pa e fshehur edhe me njëfarë ndroje. E quajta sfidë realizimin e një detyre paksa të ndryshme nga ajo që bëj në AFA, një sfidë, faktin e një jetese për 6 muaj në një mjedis shumëkombësh. Por vetë natyra e detyrës që unë mbuloj, Bashkëpunimi Civilo-Ushtarak, m’i ka lehtësuar disi përpjekjet e mia. Veproji si oficer e parë koordinuese për çështjet e infrastrukturës civile me organizatat joqeveritare, lokale e shtetërore, kompanitë publike më kryesore si energjia, ujësjells, etj., në mbarë Kosovën. Unë jam një nënë e re dhe duke patur një fëmijë në moshë të vogël 3 vjeçare, them se shkëputja nga familja për në periudhë 6 mujore, është një sakrificë që ne e ndërrmarim, por që nga ana tjetër na bën më të përgjegjshme për tu angazhuar maksimalisht për përmbushjen e detyrës me dinjitet, për vet figurën e femrës, të FARSH e të vendit”, u shpreh për shtypin ushtarak të FA-së shqiptare kapitene Elisabeta Alcani.



Kapitene Anita Gruda
Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes,
Officere për Forcën Tokësore në QBO, në KFOR
Misioni i parë

“Përzgjedhjen time në këtë mision personalisht e mora si sfidë më vete. Në natyrën time gjithmonë kam patur parimin “female lead from the front”, që nënkupton që këtë detyrë, përveç faktit të përzgjedhjes së një figure femërore, nga ana tjetër është një tregues se ne mundemi të bëjmë gjithçka, të marrim përsipër të mbulojmë edhe ato pozicione që në të shumtën e rasteve mbulohen nga meshkuj. Fakti që unë mbuloj një pozicion që për më tepër është pozicion shërbimi sesa zyre, përsëri nuk më ka trembur. Koordinoj menaxhimin e aktiviteteve që lidhen me operationet e forcës tokësore brënda QBO-së. Por duke e marrë me sportivitet, them se deri më tani ja kam dalë të ingranohem me lehtësi, si me punën ashtu dhe me mjedisin përreth e bashkëpunimin me shumë kolegë të vendeve të ndryshme, duke më bërë që ta ndjej veten të pranueshme e të respektueshme në këtë mjedis.”

Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura

INTERVISTOI: HAJRIE DEDAJ

Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura ka filluar implementimin e 17 shërbimeve online në platformën e-albania nëpërmjet dy sistemeve SQDNE (sistem shkëmbimi kërkesë/përgjigje midis AQFA dhe institucioneve) dhe AMS(sistem shkëmbimi kërkesë/përgjigje midis AQFA dhe çdo qytetari)

Arkivat janë memorie në jetën e kombeve, janë një vlerë e përjetshme e identitetit të një populli. Janë një shtëpi e madhe me raftë të mbushura me dokumentacione, që rrugëtojnë nëpër histori, janë fakt që asgjë dhe askush nuk mund t'i fshehë, apo ndryshojë. Arkivi është shtëpia e së vërtetës...

AQFA është institucioni qendror i sistemit të Mbrojtjes, që përgjigjet për ruajtjen dhe administrimin e fondit arkivor kombëtar, që krijohet gjatë veprimtarisë së strukturave të MM. Arkivi pasurohet me materiale kombëtare ushtarake vit pas viti, materiale të cilat pasqyrojnë historinë tonë ushtarake. Duke marrë parasysh rëndësinë që kanë, si nga ana kulturore, historike dhe shkencore, arkivat ruhen në mënyrë të përhershme. Misioni i Arkivit është të përthithë dokumentacionin e Forcave të Armatosura.

Le të njihemi shkurtimisht me rrugëtimin e këtij institucioni ndër vite...

Arkivi ka filluar rrugëtimin e tij që me themelimin e shtetit shqiptar në 1912, si një zyrë sekretarie që funksiononte pranë Shtabit Madhor. Në Nëntor 1944, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë do të bëhej streha e parë e dokumenteve zyrtare të shtetit shqiptar. Dokumentet e qeverisë, ministrive, bashkive, kuesturave, të ushtrive kuislinge, u bënë baza e Fondit Arkivor Kombëtar. Në vitin 1950 në Ministrinë e Mbrojtjes pranë Degës së Studimeve dhe Botimeve u ngrit kartoteka e historisë dhe do të funksiononte si e tillë deri në vitin 1960 si baza e themelimit të mëvonshëm e Arkivit të Ushtrisë. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 21 Mars 1964 e legalizoi atë zyrtarisht si institucion, "Arkivi i Ushtrisë" sot Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, që këtë vit përkon me 57-vjetorin e krijimit zyrtar.

Për të parë sesi funksionon AQFA dhe për t'u njohur me shumëllojshmërinë e dokumentacionit që disponon dhe projektet e realizuara e ato në proces realizimi, vizituam ambientet e Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, ku zhvilluam një intervistë me drejtorin Prof.asoc. dr Teki Kurti.

Prof.asoc.dr Kurti është në krye të këtij institucioni prej vitit 2014. Ai e konsideron veten me fat të jetë dre-

Hapen dokumentet arkivore për Luftën e Dytë Botërore dhe Luftën e Ftohtë

Dokumentet janë në dispozicion të studiuesve dhe publikut të gjerë, sidomos për studentët e masterit dhe doktoraturës



jtori i një institucioni me një rëndësi të tillë për Forcat e Armatosura.

Një nga proceset më të rëndësishme është mirëmbajtja e dokumentacionit që AQFA disponon, si realizohet mbrojtja e materialeve dhe si është situata në vendruajtjen e tyre?

Prof.asoc.dr Teki Kurti: Më përpara dokumentacionet kanë qenë të shpërndara në reparte, por tashmë ato ruhen në gjendje të mirë në godinën e vetë institucionit. Një pjesë e mirë e ambienteve të godinës është vënë në dispozicion të tyre. Temperatura dhe lagështia janë faktorët kryesor për ruajtjen e dokumentacionit, pra ambienti duhet të ketë kondicionim dhe sigurisht mbrojtje nga dielli, në mënyrë që materialet të mos dëmtohen.

Në AQFA gjenden me qindra materiale, cilat janë disa prej tyre, të cilat AQFA administron dhe i ruan me fanatizëm?

Prof.asoc.dr Teki Kurti: AQFA administron larmishmëri dokumentesh të një periudhe kohore rreth 90 vjeçare (1922-2013) të tilla si: Dokumente historike; Dokumente të LANÇ-it; Dokumente politike (v. 1945-1990); Dokumente të klasifikuar "sekret shtetëror"; Dokumente teknike; Dokumente të arsimit

ushtarak; Dokumente në figurë dhe në zë; Shtypin ushtarak; Botime dhe përmbledhje legjislacioni; Dosje personale etj. Ajo çka është më e rëndësishmja është se në varësi të institucioneve fondkrijuese dhe llojit të dokumenteve, janë krijuar dhe administrohen 535 fonde arkivore me një volum prej afërsisht 4300 metër linear, ose e shprehur ndryshe rreth 40 milion fletë, 6400 kuti, 321.698 dosje fashikuj, 3105 bobina për dokumentet e mikrofilmuara, 1398 rregullore, manuale, shtypi dhe botimet ushtarake. E gjitha kjo që ne disponojmë është një thesar, pasi pa arkiva ska histori dhe pa histori ska komb.

Arkivi ndër vite ka realizuar projekte dhe ekspozita, cilat janë më të rëndësishmet në 2 vitet e fundit?

Prof.asoc.dr Teki Kurti: AQFA ndër vite ka realizuar një serë projektesh, por një prej tyre që vlen të përmendet është dorëzimi i dokumenteve të njësive e reparteve të suprimuara. AQFA gjatë vitit 2020 mori në dorëzim të gjitha fondet arkivore të strukturave të suprimuara, që administronin komandat e forcave, rreth 40 ish reparte të suprimuara (fonde të papërpunuara). Një arritje tjetër në zbatim të akteve ligjore, me po kaq rëndësi, është marrja nga DPA e fondit të Këshillit të Mbrojtjes. Në zbatim

të VKM nr. 487 datë 17.10.1994 dhe urdhrin të Ministrit të Mbrojtjes nr. 714, datë 04.12.1995, pas 26 vitesh, u mor në administrim nga Fondet e Arkivit të Komitetit Qendror, të depozituar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, fondi arkivor i Këshillit të Mbrojtjes për vitet 1963-1991. Përgatitja e ekspozitave ka pasur si qëllim njohjen e publikut me përmbytjen e dokumenteve edhe nxitjen e frekuentimit të arkivit, ku publiku t'a perceptojë pasurinë dokumentare si pasuri të vetën. Mbajtja e ekspozitës për 55 vjetorin e Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura është një nga organizimet më mbreslënëse.

AQFA shpesh është konsideruar si një institucion hermetik, por me shërbimin online komunikimi me institucionin është lehtësuar në mënyrë të konsiderueshme. Si realizohet procesi i shërbimit online?

Prof.asoc.dr Teki Kurti: Një arritje e AQFA-së, dhe mbase më e madhja, është shërbimi ONLINE. Arkivi ynë si pjesë e kujtesës së kombit është në sprovën e hapjes dhe shërbimit të informacionit ndaj qytetarëve, institucioneve dhe studiuesve. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 153 datë 25.11.2019 "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online, nga data 1.1.2020", Arkivi Qendror i FA-së, ka filluar implementimin e 17 shërbimeve online në platformën e-albania nëpërmjet dy sistemeve SQDNE (sistem shkëmbimi kërkesë/





përgjigje midis AQFA dhe institucioneve) dhe AMS(sistem shkëmbimi kërkesë/përgjigje midis AQFA dhe çdo qytetari). Çdo qytetar apo institucion mund t'i drejtohet për informacion elektronikisht AQFA-së, në lidhje me 17 shërbimet e listuara në sistem dhe të marrë përgjigje brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj. Me VKM është përcaktuar afati 48 orë për kthimin e përgjigjeve midis institucioneve, ndërsa midis qytetarëve 15 ditë pune, sipas ligjit nr.119 "Për të drejtën e informimit". Dokumentet vulosen elektronikisht dhe dërgohen në adresat përkatëse duke respektuar afatet e kthimit të përgjigjeve. Kjo praktikë ndihmon qytetarin të kryej një kërkesë online në kushte komode (p.sh nga celulari i tij) dhe të marrë një përgjigje po ashtu komode dhe pa u sorollatur nëpër institucione. Gjithashtu, eliminohen radhët e gjata, pritjet e padëshiruara. Një element, që mund t'a quajmë "negative", nga praktika online, është mungesa e komunikimit ballë për ballë, ku jepen specifika dhe elemente më të detajuara në lidhje me plotësimin e kërkesës. Sektori i Informacionit punon aktualisht në bashkëpunim me sektorët e tjerë, për të arritur objektivat dhe për të qenë sa më korrekt në kthimin e përgjigjeve brenda afateve kohore, ku periodikisht plotësojmë regjistrin e transparencës për kthim-përgjigjet dhe hidhet tek faqja zyrtare e Ministrisë së Mbrojtjes. Pra, ajo çka dua të them është se, sot duke pasur shërbimin online kërkesat realizohen shumë më shpejt dhe të gjithë të interesuarit qofshin studiues të brendshëm, apo të jashtëm pajisen me informacionin e nevojshëm në kohë.

Çfarë mund të na thoni për deklasifikimin e dokumenteve të arkivit të ushtrisë?

Prof.asoc.dr Teki Kurti: Në zbatim të legjislacionit për informacionin e klasifikuar dhe në respekt të parimit; "Një qytetar i mirinformuar është një qytetar i lirë", në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Zbulimit në SHPPFA dhe Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, kemi nisur deklasifikimin masiv të dokumenteve. Ka përfunduar dekla-

sifikimi i dokumenteve të personelit organizimit, të arsimit ushtarak, të degëve ushtarake të 28 rretheve, të hartografisë ushtarake, si dhe ato politike që përmbajnë informacion të klasifikuar: Fondi i Komitetit Qendror të PPSH-së, Drejtoria Politike, dokumente të informacionit të klasifikuar për vitet 1946-1974. (2172 dosje); Informacioni i klasifikuar prodhuar nga komitetet e partisë në ushtri, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm, komandat, njësitë, repartet dhe institucionet ne varësi të tyre, për titullim, gradim, emërim, transferim, lëvizje, vënie në dispozicion, dalje në rezervë, dalje në lirim, dalje në pension, dalje në asistencë të kuadrit oficerë, nënoficerë, rezervistë dhe punonjës civilë; Dokumente nga fondi i Sekretariatit, (Sektori i Përgjithshëm), Shtabi

i Përgjithshëm, Drejtorisë Operative dhe Stërvitjes, Drejtorisë së Organizimit Mobilizimit. Jemi në proces për hartimin e bibliografisë për deklasifikim në vijimësi të dokumenteve që përmbajnë informacion të klasifikuar.

Tashmë nën drejtimin tuaj, AQFA boton rregullisht "Buletin Arkivor Ushtarak", sa i rëndësishëm është ky botim dhe cilin prej Buletinëve do të veçonit?



Prof.asoc.dr Teki Kurti: AQFA periodikisht boton Buletin Arkivor Ushtarak me përmbledhje dokumentesh arkivore të pa publikuara më parë. Do të veçoja botimin fundit të Buletinit Arkivor Ushtarak, i vitit 2020, me temë "Përmbledhje dokumentesh arkivore të Luftës së Dytë Botërore dhe Luftës së Ftohtë", i cili vjen në dispozicion të studiuesve dhe publikut të gjerë, me dokumente që botohen për herë të parë. Këto dokumente tashmë janë të hapura, në dispozicion të studiuesve si dhe studenteve të masterit e doktoraturës. Veçanërisht disa prej tyre, janë përzgjedhur dhe përfshirë në këtë botim.

Si trajnohet personeli për të miradministruar dokumentacionin?

Prof.asoc.dr Teki Kurti: Me një rëndësi të veçantë është vlerësuar trajnimi i personelit për metodologjinë e punës me dokumentet, të cilën e kemi realizuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe Strukturat e Forcave të Armatosura. Për të siguruar miradministrimin e dokumenteve në strukturat e FA-së, si institucione bazë fondkrijuese, puna e drejtuesve dhe e specialistëve me eksperiencë të AQFA-së ka vijuar nga trajnimet e përvitshme në dhënie ndihmë metodologjike e profesionale për punën me dokumentet në 43 sekretari-arkiva.

Projekti për digjitalizimin e arkivës ushtarake është shumë i vlefshëm, pasi do t'i sjellë më afër qytetarët, studiuesin e brendshëm dhe atë të jashtëm. Si po ndiqet ky proces?

Prof.asoc.dr Teki Kurti: Prioritet kryesor në rrugën tonë mbetet modernizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së ruajtjes dhe shërbimit të dokumenteve si për qytetarët, institucionet, studiuesit e brendshëm dhe ata të huaj. Për këtë në bashkëpunim me Drejtorinë e Inovacionit dhe Automatizimit në Ministrinë e Mbrojtjes, u arrit miratimi i projektit për "Sistemimin e digjitalizimin të fondeve arkivore" ku pritet vetëm financimi i tij për zbatim.

NË KOMANDËN E FORCËS AJRORE

Zhvillohet Konferenca Fillestare e Planëzimit “Ambicia e Shqiponjës”

Konferenca kishte si qëllim prezantimin e objektivave të stërvitjes, e cila parashikohet të zhvillohet në muajin korrik 2021

Në Komandën e Forcës Ajrore u zhvillua më 19 mars 2021, Konferenca Fillestare e Planëzimit “Ambicia e Shqiponjës” me pjesëmarrjen e shtabit të Forcës Ajrore, personelit të Qendrës së Kontroll-Raportimit, si dhe përfaqësues të Bazës Ajrore Farkë.

Shefi i Shtabit të Forcës Ajrore, kolonel Arben Cenolli në fjalën e tij prezantoi qëllimin dhe objektivat e stërvitjes, e cila parashikohet për t’u zhvilluar në muajin korrik 2021.

Kjo stërvitje ka si qëllim shfrytëzimin e kapaciteteve të postit të kontroll-raportimit “Control Reporting Post”

të radarit dhe shndërrimi i saj në qendër operacionale ajrore “Control Reporting Center” të Forcës Ajrore dhe/ose qendër e operacioneve ajrore të një komponenti Ajror.

Konferenca përfundoi me diskutimet e secilit aktor në stërvitje, duke i vënë theksin kalendarit dhe specifikimeve të stërvitjes si dhe u përgatit drafti i parë i planëzimit të stërvitjes. Më pas, nga përfaqësuesi i degës së operacioneve të Forcës Ajrore u prezantua skenari i stërvitjes dhe fazat e saj, të cilat do të vijojnë me procesin e planëzimit të moduleve të stërvitjeve.



Këshilli i Ministrave

Agjencia e Mbrojtjes Civile dhe gjendja e fatkeqësisë natyrore

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile analizon të dhënat, paraqet raportin e situatës dhe i propozon ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore

Këshilli i Ministrave, në mbledhjen e datës 17 mars 2021, ka miratuar vendimin “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, ku një rol të rëndësishëm ka edhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, e cila është në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave gjendja e fatkeqësisë natyrore shpallet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore, të prekura nga pasojat e shkaktuara nga fatkeqësia, nuk janë në gjendje ta përballojnë atë.

Shpallja e gjendjes së emergjencës dhe klasifikimi i llojit të saj varen nga këta faktorë: shtrirja territoriale e zonës së dëmtuar ose të prekur, sipas rastit; ndikimet e këtyre dëmeve në prishjen e ekuilibrit të jetës normale të komunitetit; të dhënat shkencore nga institutet/strukturat përkatëse, për rastin konkret të fatkeqësisë.

Shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe klasifikimi i llojit të saj varen nga këta faktorë: për tërmetet, të dhënat e para jepen nga strukturat brenda 2 (dy) orëve dhe në mënyrë periodike për vijueshmërinë e goditjeve sizmike, dëmet e shkaktuara në humbje të jetëve njerëzore, banesa dhe dëme të tjera infrastrukturore, deri në shuarjen përfundimtare të goditjeve sizmike; për përmblytjet dhe vërshimet e ujit, që vijnë si rezultat i rritjes në nivele kritike të ujit, nga faktorë gjeologjikë, atmosferikë apo njerëzorë, në shtratin e lumenjve, në nivelin e liqeneve apo në baticat bregdetare, duke mbuluar përkohësisht me ujë sipërfaqe toke në atë nivel që përbëjnë rrezik për njerëzit, banesat dhe infrastrukturën; temperaturat ekstreme e të tejzgjatura, kur këto shkaktojnë dëme serioze në jetën dhe shëndetin e njerëzve, edhe në pasuritë e tyre; rrëshqitjet arkitektonike të shkaktuara drejtpërdrejt nga një ngjarje tërmeti apo nga dukuri të tjera gjeologjike, të cilat kanë shkaktuar humbje të jetëve njerëzore, të gjësë së gjallë ose dëme në banesa dhe infrastrukturë; për ortekët e formuar nga dëborat e akumuluar dhe e paqëndrueshme, në terrene të pjerrëta mjaftueshëm (mbi 30°), rënia e të cilëve ka shkaktuar dëme të konsiderueshme në njerëz dhe në gjënë e gjallë ose bllokim të rrjetit të infrastrukturës kritike; për erërat e forta në tokë dhe në det, kur ato zgjasin në kohë e në hapësirë, duke sjellë probleme për transportin rrugor dhe atë detar, duke u shoqëruar me rrëzime të pemëve, të objekteve apo të strukturave të ndryshme me rrezik për



aksidente, gjymtime e dëme të pronës dhe, me raste, kërcënim të jetës; për zjarret masive në pyje apo në zona të populluara, kur ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë të flakëve, në zonat e ekspozuara, duke kërcënuar jetën e njeriut, pronën dhe gjënë e gjallë, shoqëruar me temperatura të larta dhe erëra të forta, duke bërë edhe kontrollin e tyre shumë të vështirë; për sëmundje infektive me përhapje masive, të cilat mund të jenë epidemi, e cila është paraqitura e dy dhe më shumë rasteve të sëmundjeve infektive, të lidhura në kohë e në territor apo rritje mbi normën e prituri të numrit të rasteve të sëmundjes dhe pandemi, ku përhapja masive e sëmundjes ngjitetë i kalon kufijtë e shtetit, duke përfshirë disa shtete e më shumë se një kontinent; për aksidentet teknologjike që vijnë si rezultat i sulmeve terroriste, të problemeve teknike të pajisjeve prodhuese, dështimeve teknike, kompleksitetit të tepërt të procesit të prodhimit, gabimeve në projektim dhe prodhim, zhvlerësim

të pajisjeve, mjeteve të vjetëruara të prodhimit, gabimeve apo dëmtimeve me dashje të personelit, keqkuptimeve për veprimet e përbashkëta të profesionistëve, faktorë të jashtëm etj., kur këto shkaktojnë dëme serioze në jetën, shëndetin e njerëzve e në pasuritë e tyre; për aksidentet rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, që vijnë si rezultat i dështimeve, gabimeve njerëzore, dobësive të thella strukturore të vetë mjeteve, teknikës apo të infrastrukturës së tyre, ose faktorë të jashtëm, të cilët shkaktojnë dëme serioze në jetën, shëndetin e njerëzve dhe në pasuritë e tyre; për aksidentet bërthamore apo radiologjike, që vijnë si rezultat i zhvillimeve të pakontrolluara të ciklit të prodhimit nga operatorë të ndryshëm apo të ndërmarrjeve me veprimtari me rrezatime jonizuese, një situatë jo e zakonshme ose ngjarje që përfshin një burim rrezatimi që dikton masa të menjëhershme për të zbutur pasojat e rënda të dëmshme për sigurinë, shëndetin e njeriut, cilësinë e jetës, pronën ose mjedisin ose një

emergjencë në të cilën ka ose parashikohet të ketë një rrezik nga energjia si pasojë e reaksionit zinxhir bërthamor ose nga zbërthimi i produkteve të një reaksioni zinxhir bërthamor ose ekspozimi ndaj rrezatimit; rrëzimet e digave të shkaktuara drejtpërdrejt nga një ngjarje tërmeti, nga amortizimi në vite, ndryshimi i kushteve klimatike etj., që sjellin si pasojë përmblytje masive, të cilat shkaktojnë dëme serioze në jetën, shëndetin e njerëzve e në pasuritë e tyre, si dhe kolaps në ekonomi; për dukuri natyrore ekstreme apo fatkeqësi të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, në gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

Institucionet, institutet dhe strukturat kryesore të ngarkuara për dhënien e informacionit dhe vlerësimin paraprak të dëmeve për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore janë: ministritë, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore apo të kompetencave që kanë lidhje me dukurinë natyrore apo fatkeqësitë e tjera; institutet/strukturat shtetërore përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e shkallës së fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësitë e tjera; prefekti i qarkut; bashkia në territorin e së cilës ndodh fatkeqësia.

Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, kur sigurohen të dhënat, të këtij vendimi, ndiqen këto procedura:

Në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në një kohë sa më të shpejtë nga momenti i konstatimit të një dukurie, të parashikuar më sipër, dërgohen raporte me të dhëna nga autoritetet e listuara, më poshtë vijon: institucionet, institutet dhe strukturat shtetërore përgjegjëse për monitorimin e vlerësimin e intensitetit të fatkeqësisë, të cilat, në varësi të llojit të fatkeqësisë, dërgojnë të dhënat e para të regjistruara në mënyrë periodike, plotësojnë këto të dhëna, përgatisin raporte deri në shuarjen e plotë të

aktivitetit të fatkeqësisë; prefekti i qarkut dhe kryetari i bashkisë, për gjendjen e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia në territorin e përgjegjësisë së tyre.

Raporti i vlerësimit paraprak të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia, i dërguar nga kryetari i bashkisë dhe prefekti i qarkut, shoqërohet me kërkesë për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore; me marrjen e të dhënave dhe të kërkesës, sipas shkronjave, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile analizon e vlerëson të dhënat dhe paraqet raportin e situatës e, sipas rastit, i propozon ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore; Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile, vendos shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë në të gjithë territorin ose për një pjesë të territorit të vendit. Nisma për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore për rastet sipas pikës 10, të nenit 3, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, ndërmerret nga ministritë e linjës, sipas veçorive që shfaqen, si dhe fushës së përgjegjësisë shtetërore apo kompetencave që mbulojnë, në bashkëpropozim me ministrin përgjegjës për mbrojtjen civile, bazuar në informacionin e marrë nga institutet/strukturat shtetërore përkatëse dhe organet e vetëqeverisjes vendore të prekura nga fatkeqësia.

Vendimi nr.664, datë 18.12.2002, i Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e shpalljes së gjendjes së emergjencës civile”, shfuqizohet. Ngarkohen të gjitha ministritë, institutet kërkimore e shkencore, të këtij vendimi, entet publike, sipas fushave të përgjegjësisë shtetërore që mbulojnë për mbrojtjen civile, në bashkëpunim me organet e vetëqeverisjes vendore, për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

QENDRA STËRVITORE E FORCËS TOKËSORE

Këmbësori dhe Kimi: Përfundon Kursi Bazë dhe i Avancuar i Nënoficerit

Kursi Bazë dhe ai i Avancuar i Nënoficerit, në Qendrën Stërvitore, vazhdoi për një periudhë 8 javore dhe u ndoq nga rreth 25 kursantë

Qendra Stërvitore e Forcës Tokësore mbylli, më 19 mars 2021, me sukses Kursin Bazë dhe atë të Avancuar të Nënoficerit, në specialitetin Këmbësori dhe Kimi. Në ceremoninë e organizuar mori pjesë shefi i Shtabit të Forcës Tokësore, kolonel Ilirjan Dauti, komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ekland Dauti si dhe stafi mësimdhënës i Qendrës Stërvitore.

Fjalën e hapjes e mbajti Komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel Ekland Dauti, i cili pasi theksoi rëndësinë e kursit të sapo mbyllur, ndër të tjera vlerësoi bashkëpunimin me Komandën dhe Shtabin e FT-së, si dhe koordinimin e shkëlqyer me Akademinë e Forcave të Armatosura për realizimin e një programi sa më cilësor stërvitje.

“Theksojmë me krenari se personeli i Qendrës Stërvitore, vazhdon t’i qëndrojë besnik asaj që bashkarisht kemi vendosur të zbatojmë, në të gjithë kurset që zhvillohen, vlerësimin real sipas meritës së gjithsecilit.”, - tha në fjalën e tij kolonel Dauti.

Një falënderim të veçantë, ai përcolli edhe për stafin e instruktorëve për devotshmërinë dhe profesionalizmin e



Dita Ndërkombëtare e Meteorologjisë

treguar. Më pas fjalën e mori shefi i Shtabit të Forcës Tokësore, kolonel Ilirjan Dauti: “Themi shpesh se nënoficeri është shtylla kurrizore e ushtrisë dhe në fakt kështu është dhe kështu duhet të jetë. Procesin që nisët këtu, ju duhet ta vazhdoni më tej dhe jo ta ndërprisni në repartet ku ju shërbeni, me shembullin disiplinën dhe rritjen tuaj kulturore, duke lexuar studiuar dhe u stërvitur çdo ditë.”, - tha ai. Ceremonia vazhdoi me ndarjen e certifikatave dhe u mbyll me një foto të përbashkët. Kursi Bazë dhe ai i Avancuar i Nënoficerit në Qendrën Stërvitore vazhdoi për një periudhë 8 javore dhe u ndoq nga rreth 25 kursantë duke zbatuar të gjitha masat anti COVID-19.

Shërbimi meteorologjik ushtarak në funksion të FA-së dhe strukturave civile

bashkëpunim me FORS Montenegro (Fondacioni për Zhvillimin e Veriut të Malit të Zi), zgjodhi Shërbimin Meteorologjik Ushtarak për realizimin e këtij projekti. Nga ky projekt Shërbimi Meteorologjik Ushtarak përfitoi 4 stacione automatike hidrometeorologjike,

Ajrore në fjalën përmbyllëse iu shprehu edhe një herë falënderimet më të sinqerta Prefekturës Shkodër, të cilët bënë të mundur realizimin e këtij projekti si dhe falënderimin tjetër ia adresoi të gjithë personelit të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak e në veçanti

Më pas, Prefektja e qytetit të Shkodrës falënderoi Komandën e Forcës Ajrore për bashkëpunimin e mirë e të vazhdueshëm, në shërbim të komunitetit dhe siguroi që mbështetja dhe bashkëpunimi do të jetë në vazhdimësi edhe në të ardhmen.

Aktiviteti u mbyll me një foto të përbashkët. Gjithashtu zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore më herët realizoi një vizitë në ambientet e Shërbimit Meteorologjik Ushtarak në Tiranë dhe uroi personelin civil dhe ushtarak me rastin e 66-vjetorit të krijimit të këtij shërbimi, si dhe i falënderoi ata për kontributin e

tyre në vite. Ndërkohë zhvilloi një takim edhe me personelin femër të shërbimit meteorologjik, të cilat, në këtë ditë të shënuar të meteorologjisë, i uroi për punën, përkushtimin dhe eksperiencën në fushën e meteorologjisë dhe shërbimin e tyre në Forcën Ajrore.

Organizata Botërore Meteorologjike është themeluar më 23 mars të vitit 1950, si organizatë ndërqeveritare dhe agjenci e veçantë e Kombeve të Bashkuara, e cila bashkon 188 shtete anëtare me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shërbimeve meteorologjike, e cila është pasardhëse e Organizatës Internacionale Meteorologjike (Organizata Ndërkombëtare Meteorologjike IMO) e themeluar në vitin 1873 në Vjenë. Selia e Organizatës Botërore Meteorologjike është në Gjenevë.



nga të cilat 2 stacione meteorologjike të instaluar përkatësisht në Stacionin Meteorologjik Shkodër dhe Lezhë, si dhe instalimi i 2-stacioneve hidrike për matjen e prurjeve të lumenjve të zonës Shkodër. Të dhënat që do të gjenerohen nga këto stacione, do të jenë në përdorim të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak, Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile dhe Prefekturës Shkodër. Ky investim me rëndësi do t’i shërbejë modernizimit të shërbimit meteorologjik ushtarak dhe rritjes së cilësisë së raportimeve dhe informacioneve që ky shërbim do të japë në qarkun e Shkodrës por jo vetëm.

Zëvendëskomandanti i Forcës

personelit të Stacionit Shkodër, në ditën e Meteorologjisë; pasi ky specialitet kaq i veçantë dhe i rëndësishëm nuk do të kishte vlerën që ka, pa punën e specialistëve, vrojtuesve dhe parashikuesve meteorologë, të cilët japin çdo ditë kontributin e tyre, që ky Shërbim të vazhdojë misionin e tij në shërbim të Forcave të Armatosura, Agjencisë së Emergjencave Civile, Bashkive dhe Prefekturave si dhe gjithë Komunitetit në lajmërimin në kohë të situatave emergjente me qëllim parandalimin e fatkeqësive ashtu sikurse aq bukur e thotë moto me të cilën ky shërbim udhëhiqet në punën e tij: “Të parandalosh është më mirë se të kurosh”.

Bogë-Qafë Thorë: Zhblllokohen 12 km rrugë në drejtim të Thethit

Efektivët xheniere të Komandës Mbështetëse, kanë vijuar me mbështetjen e komunitetit të bashkisë Koplik për zhbllokimin e rrugës nga dëbora. Si pasojë e uljes së temperaturave dhe shtimit të reshjeve, dëbora në këtë zonë arriti javën që kaloi trashësinë 3-5 metra, duke krijuar një situatë të pazakontë, duke paralizuar plotësisht lëvizjen e mjeteve në aksin rrugor Theth-Bogë me pikë kritike në Qafë Thorë. Me ndërhyrjen e menjëherëshme të forcave xheniere me mjetet borëpastruese u bë i mundur zhbllokimi i 12 km rrugë nga Boga në Qafë-Thorë dhe tashmë ky segment është i kalueshëm. Aktualisht, efektivat xheniere, në bashkëpunim dhe me bashkinë Shkodër vijojnë punën për zhbllokimin e pjesës tjetër të aksit rrugor Qafë Thorë - Theth.



Më 23 mars, me rastin e 66-vjetorit të Krijimit të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak, zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj mori pjesë në aktivitetin e organizuar në ambientet e Stacionit Meteorologjik Ushtarak në Shkodër. Të pranishëm në aktivitet ishin edhe Prefektja e qytetit të Shkodrës Znj. Majlinda Angoni si dhe drejtues e punonjës të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak.

Kolonel Ylli Pulaj në fjalën e hapjes falënderoi Prefektin për praninë dhe bashkëpunimin e mire, duke theksuar se zgjodhi Stacionin e Shkodrës që të uronte personelin civil dhe ushtarak në ditën e 66-vjetorit të Krijimit të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak por edhe në ditën botërore të shërbimit meteorologjik. Ai vlerësoi kontributin e këtij shërbimi qysh nga dita e krijimit, shërbim ky, i cili ka mbështetur me informacion meteorologjik jo vetëm Forcat e Armatosura dhe Forcat Ajrore në veçanti por ka qenë një pikë e rëndësishme referuese në paralajmërimin e situatave emergjente që janë krijuar si shkak i kushteve ekstreme meteorologjike në vendin tonë.

Në vijim ai theksoi se, jo rastësisht në këtë ditë përkujtimore të shërbimit meteorologjik u zgjodh Stacioni i Shkodrës. Shkodra është një nga qytetet që ka pasur më shumë probleme me situatën e krijuar për shkak të motit ekstrem duke sjellë në kujtesë vitin 2010, ku Shkodra dhe gjithë Rajoni Veriperëndimor patën situatën më të vështirë të përmbytjeve dhe dëmeve të shkaktuara nga moti ekstrem.

Pikërisht duke qenë një problem për të gjithë dhe i të gjithëve, Bashkimi Evropian në mënyrë domethënëse ka iniciuar dhe financon projektin “Katastrofat nuk njohin kufij”. Në këtë kuadër Prefektura Shkodër, në

Bruksel, 23-24 mars 2021: Takimi i ministrave të Jashtëm të NATO-s

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Më 23 dhe 24 mars 2021, ministrat e Jashtëm të NATO-s zhvilluan takimin e tyre ministerial në Bruksel. Në datën 23 mars, aleatët shkëmbyen mendime mbi iniciativën e NATO-s 2030 për të mbrojtur të ardhmen e Aleancës, e cila do të jetë në zemër të Samitit. Z. Stoltenberg shpjegoi: “Ne duhet të jemi të guximshëm dhe ambiciozë për të ndërtuar një Aleancë më të fortë për të ardhmen, sepse ne jetojmë në një botë më të rrezikshme dhe konkurruese, ku sfidat nuk njohin kufij”. Ai gjithashtu vuri në dukje se tani ekziston një mundësi për të hapur një kapitull të ri në marrëdhëniet transatlantike. Ministrat gjithashtu vazhduan konsultat e tyre në lidhje me praninë e NATO-s në Afganistan dhe procesin e paqes në vazhdim. Sekretari i Përgjithshëm tha se “Ne mbështesim fuqimisht përpjekjet për të futur energji të freskëta në procesin e paqes. Kjo kërkon që të gjitha palët të punojnë për të arritur progres, për të ulur nivelet e larta të dhunës dhe për të negociuar në mirëbesim. Kjo gjithashtu kërkon angazhim konstruktiv nga të gjithë aktorët rajonalë dhe bashkësia ndërkombëtare.” Ministrat gjithashtu do të vlerësojnë qasjen e NATO-s në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut dhe do të shikojnë se çfarë mund të bëjë më shumë NATO për të ndërtuar stabilitetin në rajon.

Më 24 mars 2021 aleatëve iu bashkuan kombet partnere Finlanda dhe Suedia, si dhe Përfaqësuesi i Lartë i BE Josep Borrell, për një diskutim mbi Rusinë. Sekretari i Përgjithshëm tha se “Rusia vazhdon të shtypë disidentët paqësorë në vend dhe të shfaqë një model të sjelljes agresive jashtë vendit, përfshirë sulmet kibernetike dhe përpjekjet për të ndërhyrë në zgjedhjet tona dhe minuar demokracitë tona. Si Aleancë, ne qëndrojmë të përkushtuar në qasjen tonë me dy drejtime ndaj Rusisë: parandalim dhe mbrojtje e fortë, e kombinuar me hapjen e dialogut kuptimplotë, përfshirë çështje të tilla si kontrolli i armëve.” Ministrat u takuan personalisht në Selinë e NATO-s për herë të parë pas më shumë se një vit dhe iu përmbajtën masave të rrepta shëndetësore.

Pikëpamje mbi axhendën NATO-s 2030, Afganistanin dhe sigurinë në rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut

Më 23 mars 2021, Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg deklaroi përfundimet e ditës së parë të takimeve të ministrave të Jashtëm të NATO-s në Selinë e NATO-s. “Ministrat kanë pasur një diskutim shumë pozitiv mbi iniciativën tonë NATO 2030. Kjo ka të bëjë me atë se si NATO mund të vazhdojë të përshtatet në një mjedis sigurie që ndryshon me shpejtësi, me kërcënime në rritje dhe konkurrencë sistematike, ndryshime të mëdha në ekuilibrin global të fuqisë dhe sfida në rritje të rregullave të rendit ndërkombëtar”, tha Stoltenberg. “Ne të gjithë jemi dakord që marrëdhënia transatlantike, e mishëruar nga NATO, mbetet gurthemeli i mbrojtjes sonë kolektive, thelbësore për kohezionin tonë politik dhe një shtyllë thelbësore për rendin e bazuar në rregulla,” vuri në dukje ai. Për Afganistanin, “Ministrat theksuan

NATO hedh bazat për Samitin e ardhshëm të Aleancës



mbështetjen e tyre të plotë për të gjitha përpjekjet për të gjallëruar procesin e paqes, sepse një zgjidhje e negociuar është mënyra e vetme për të arritur një paqe të qëndrueshme, e cila parandalon Afganistanin që përsëri të bëhet një platformë për terrorizmin ndërkombëtar”, theksoi Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. “Ne do të vazhdojmë të këshillohemi shumë ngushtë në ditët dhe javët në vijim, dhe ne do të vazhdojmë të vendosim dhe të veprojmë së bashku, si aleatë,” shtoi ai. Më në fund, ministrat patën një shkëmbim në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, përfshirë Misionin e NATO-s në Irak. Ata rikthyen rëndësinë për të forcuar partneritetet e NATO-s në rajon.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg përmbledhi ditën e parë të ministerialit të Punëve të Jashtme të NATO-s, në deklaratën që dha për shtypin: “Sapo kemi përfunduar dy takime produktive të ministrave të Jashtëm të NATO-s, për t’u përgatitur për Samitin tonë më vonë këtë vit. Ky do të hapë një kapitull të ri në marrëdhëniet midis Amerikës së Veriut dhe Evropës dhe është platforma perfekte për të vendosur drejtimin për të ardhmen e Aleancës sonë. Ministrat kanë pasur një diskutim shumë pozitiv mbi iniciativën tonë NATO 2030. Kjo ka të bëjë me atë se si NATO mund të vazhdojë të adaptohet në një mjedis sigurie që ndryshon me shpejtësi, me kërcënime në rritje dhe konkurrencë sistematike, ndryshime të mëdha në ekuilibrin global të fuqisë dhe sfida në rritje të rregullave të rendit ndërkombëtar. Ndiej mbështetje të konsiderueshme për një axhendë të guximshme dhe ambicioze të NATO-s 2030. Ne të gjithë jemi dakord që marrëdhënia transatlantike, e mishëruar nga NATO, mbetet gurthemeli i mbrojtjes sonë kolektive, thelbësore për kohezionin tonë politik, dhe një shtyllë thelbësore për rendin e bazuar në

rregulla. Në përgjigje të një mjedisi më të rrezikshëm dhe të paparashikueshëm të sigurisë, ne po forcojmë ndjeshëm parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s. Ne jemi dakord që duhet dhe do të bëjmë më shumë, kjo është mënyra më e mirë për të demonstruar solidaritetin, unitetin dhe vendosmërinë tonë politike. Kjo është arsyeja pse unë kam propozuar një rritje thelbësore në fondet e përbashkëta për të mbështetur parandalimin dhe mbrojtjen, në Aleancën tonë. Ne gjithashtu diskutuam se si mund të forcojmë rolin e NATO-s si platforma kryesore transatlantike, për të diskutuar dhe koordinuar për të gjitha çështjet që ndikojnë në sigurinë tonë të përbashkët. Ne adresuam se si mund të rrisim qëndrueshmërinë tonë duke vendosur standarde minimale midis aleatëve për infrastrukturën kritike siç janë telekomunikacioni dhe furnizimi me energji. Ne ramë dakord që duhet të rrisim punën tonë për të ruajtur avantazhin tonë teknologjik dhe për të nxitur bashkëpunimin transatlantik në teknologjitë në zhvillim dhe përçarës dhe përqendrohemi në implikimet e sigurisë së ndryshimit të klimës. Unë besoj se NATO mund të udhëheqë në këtë fushë, dhe kontribuojnë në arritjen e qëllimit të Net Zero.

Sot, Ministrat ndërmorën hapat e parë duke rënë dakord për një raport i cili do të rrisë aftësinë tonë për të kuptuar, përshtatur dhe zburuar ndikimin e sigurisë së ndryshimit të klimës. Më tej, ministrat diskutuan se si mund të miratonim një këndvështrim më global. Duke forcuar bashkëpunimin me partnerë të një mendjeje në të gjithë botën, përfshirë Bashkimin Evropian, për të mbrojtur rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla dhe për të trajtuar sfidat e përbashkëta dhe duke rritur aftësinë tonë për të ofruar trajnime dhe mbështetje për partnerët tanë. Ministrat mirëpritën rekomandimin për të azhur-

nuar Konceptin Strategjik të NATO-s. Të gjitha këto propozime të NATO-s 2030 dërgojnë një mesazh të fortë kohezioni, solidariteti dhe vendosmërie politike. Ministrat gjithashtu vazhduan konsultat për praninë tonë në Afganistan. Të gjithë e shohim se nuk ka zgjidhje të lehtë. Nuk ka rrugë pa rreze përpara dhe ne duhet të përgatitemi për të gjitha opsionet. Ministrat theksuan mbështetjen e tyre të plotë për të gjitha përpjekjet për të gjallëruar procesin e paqes. Sepse një zgjidhje e negociuar është mënyra e vetme për të arritur një paqe të qëndrueshme, e cila parandalon Afganistanin që përsëri të bëhet një platformë për terrorizmin ndërkombëtar. Të gjitha palët duhet ta shfrytëzojnë këtë mundësi historike pa vonesa të mëtejshme dhe të gjithë aktorët rajonalë dhe ndërkombëtarë duhet të luajnë rolin e tyre për të mbështetur një Afganistan paqësor dhe të qëndrueshëm.

NATO ka rreth 10,000 trupa në Afganistan. Shumica janë nga aleatë dhe partnerë jo-amerikanë. Sot, ne nuk morëm asnjë vendim përfundimtar për qëndrimin e forcës sonë, por jemi të vendosur të marrim të gjitha masat e nevojshme për t’i mbajtur trupat tona të sigurta. Ne do të vazhdojmë të këshillohemi shumë ngushtë në ditët dhe javët në vijim dhe do të vazhdojmë të vendosim dhe veprojmë së bashku, si aleatë. Ministrat gjithashtu patën një shkëmbim në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, duke përfshirë misionin tonë në Irak dhe mbështetjen tonë për partnerët në rajon. Për të ndërtuar një stabilitet më të madh, ne duhet të përforcojmë partneritetin tonë me organizatat ndërkombëtare, veçanërisht me Bashkimin Evropian dhe Kombet e Bashkuara dhe ne mbetemi të hapur për të punuar me vendet e reja partnere që ndajnë vlerat tona.”

Ministrat e Jashtëm të NATO-s diskutojnë Rusinë dhe kontrollin e armëve

Ministrat e Jashtëm të vendeve aleate u takuan në Selinë e NATO-s në Bruksel më 24 mars 2021 për diskutimin mbi Rusinë dhe kontrollin e armëve. Takimi iu bashkuan me kombet partnere, Finlanda dhe Suedia, si dhe Përfaqësuesi i Lartë i BE Josep Borrell. “Rusia ka rritur modelin e saj të sjelljes shtypëse në vend dhe sjellje agresive jashtë vendit,” tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg. Ai theksoi se qasja e dyfishtë e NATO-s ndaj Rusisë, duke kombinuar parandalimin e fortë dhe mbrojtjen me hapjen ndaj dialogut, mbetet e vlefshme. Ai nënvizoi se të gjithë aleatët e mirëpresin vendimin e fundit për të zgjeruar Traktatin NEW START dhe se NATO mbetet një platformë unike për Evropën dhe Amerikën e Veriut për t’u konsultuar për të ardhmen e kontrollit të armëve.

Në konferencën për shtyp të ditës dytë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, deklaroi: “Ministrat e

Jashtëm të NATO-s sapo kanë përfunduar një diskutim mbi Rusinë. Na u bashkuan me partnerët tanë të ngushtë, Finlanda dhe Suedia, si dhe Përfaqësuesi i Lartë i BE-së, Nënpresidenti Borrell. Ndërsa marrëdhënia jonë me Rusinë mbetet shumë e vështirë, takimi ynë sot demonstroi marrëveshje të fortë midis aleatëve dhe me partnerët tanë. Pavarësisht viteve të presionit dhe përpjekjeve për t’u përfshirë në një dialog kuptimplotë, Rusia ka rritur modelin e saj të sjelljes shtypëse brenda dhe sjelljen agresive jashtë vendit. Në Rusi, ne ende shohim shtypje të dhunshme të mospajtimin politik. Ne bëjmë thirrje për lirin e menjëhershme të Alexei Navalny dhe demonstruesve të tjerë paqësorë të cilët janë arrestuar. Jashtë vendit, Rusia minon dhe destabilizon fqinjët e saj, duke përfshirë Ukrainën, Gjeorgjinë dhe Republikën e Moldavisë. Ajo mbështet shtypjen e Bjellorusisë dhe përpjekjet e ndërhyrjes në rajonin e Ballkanit Perëndimor, Rusia vazhdon vendosjen e saj të gjerë ushtarake nga Baltiku në Detin e Zi, në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut dhe nga Mesdheu në Arktik.

Aleatët kanë bërë thirrje për dezinformimin dhe propagandën e Rusisë, përpjekjet e saj për të ndikuar në zgjedhje, sulmet kibernetike dhe përdorimi prej saj i armëve kimike kundër kundërshtarëve politikë, si në vend ashtu edhe në territorin tonë. Përgjigja e NATO-s është e vendosur dhe e qëndrueshme. Në përgjigje të veprimeve të Rusisë, NATO ka zbatuar përforsimin më të madh të mbrojtjes sonë kolektive në një brez. Ne kemi rritur mbrojtjen tonë hibride dhe kibernetike. Ne do të qëndrojmë vigjilentë dhe ne do të vazhdojmë të punojmë me BE dhe partnerët tanë të ngushtë, për t’u siguruar që ne t’i përgjigjemi veprimeve të Rusisë së bashku.

Aleatët bien dakord që ne duhet të vazhdojmë të rishikojmë dhe adaptojmë parandalimin dhe mbrojtjen tonë, përfshirë kur bëhet fjalë për kërcënimin në rritje të raketave ruse. Qasja jonë me dy drejtime kombinon parandalimin dhe mbrojtjen e fortë, me hapjen për dialog. Të gjithë aleatët qëndrojnë fort të vendosur për kontrollin e armëve bërthamore dhe të gjithë aleatët e mirëpresin vendimin e fundit për të zgjeruar Traktatin e New Start. Ky duhet të jetë fillimi i një përpjekje për të forcuar më tej kontrollin ndërkombëtar të armëve bërthamore. Ne shohim se Rusia vazhdon të vendosë armë të reja dhe destabilizuese bërthamore. Na duhen marrëveshje që mbulojnë më shumë armë dhe më shumë kombe si Kina. Pra, regjimi i kontrollit të armëve duhet të marrë parasysh realitetet e reja. NATO ka një angazhim të fortë dhe të gjatë për kontrollin e armëve, çarmatimin dhe mospërhapjen e armëve, dhe ne mbetemi një platformë unike për Evropën dhe Amerikën e Veriut që të këshillohen për të ardhmen e kontrollit të armëve, sepse ndihmon në ruajtjen e paqes.”

NATO mbështet BH për reformimin e institucioneve të sigurisë

Më 18 mars 2021, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană foli për zhvillimin e marrëdhënieve midis NATO-s dhe Bosnjë dhe Hercegovinës dhe për angazhimin e vazhdueshëm të Aleancës për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor, në një konferencë ndërkombëtare mbi “Proceset Euro-Atlantike në Bosnjë dhe Hercegovina” organizuar nga Universiteti i Mostarit. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm nënvizoi mbështetjen e vendosur të NATO-s për përpjekjet e vazhdueshme të Bosnjë dhe Hercegovinës për të reformuar institucionet e tyre të mbrojtjes dhe

të sigurisë, përmes aktiviteteve të përditshme të Selisë së NATO-s Sarajevë. Ai theksoi fusha të tjera të rëndësishme të mbështetjes praktike nga NATO, duke përfshirë teknologjitë e reja, reagimin ndaj katastrofave, zbulimin e eksplozivëve, mbrojtjen kibernetike, luftimin e dezinformimit dhe bashkëpunimin shkencor. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Geoană gjithashtu mirëpriti kontributet e rëndësishme të Bosnjë dhe Hercegovinës në sigurinë euro-atlantike dhe theksoi se bashkëpunimi do të vazhdojë të informohet nga respektimi i plotë i NATO-s për sovranitetin dhe pavarësinë e vendit.



Jens Stoltenberg mirëpriti Sekretarin e Shtetit të SHBA Antony Blinken

Stoltenberg: Jo vetëm Europa, jo vetëm Amerika

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg mirëpriti Sekretarin e Shtetit të SHBA Antony Blinken në Selinë e NATO-s më 23 mars 2021, përpara takimeve të ministrave të Jashtëm aleatë. Sekretari i Përgjithshëm vlerësoi angazhimin e fortë personal të Sekretarit Blinken ndaj NATO-s, dhe tha se “tani kemi një mundësi unike për të filluar një kapitull të ri në marrëdhëniet transatlantike”. Z. Stoltenberg tha se ministreriali i kësaj jave ofron një mundësi për të bërë përparim në iniciativën NATO 2030, duke përgatitur një axhendë ambicioze transatlantike për Samitin e ardhshëm.

Deklarata nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg dhe Sekretari i Shtetit i SHBA Antony Blinken në fillim të takimeve të Ministrave të Jashtëm të NATO-s

Jens Stoltenberg: Ju keni dekada përvojë të politikës së jashtme dhe përvojë të sigurisë kombëtare. Ju keni një angazhim të fortë personal ndaj NATO-s, në lidhjen transatlantike. Prandaj, me të vërtetë e vlerësoj këtë mundësi për t’ju mirëpritur në vizitën tuaj të parë në Evropë, në Selinë e NATO-s. Tani kemi një mundësi unike për të filluar një kapitull të ri në marrëdhëniet transatlantike dhe unë e mirëpres fuqimisht mesazhin e administratës Biden për rindërtimin e aleancave dhe forcimin e NATO-s. Kjo është ajo që ka të bëjë me iniciativën tonë NATO 2030. Për shkak se përballemi me sfida të mëdha globale: Aktivitetet destabilizuese të Rusisë, kërcënimi i terrorizmit, sulmet kibernetike dhe përhapja bërthamore, teknologji përçarëse, ngritja e Kinës dhe ndikimi i sigurisë së ngrohjes globale dhe ndryshimit të klimës. Asnjë vend dhe asnjë kontinent nuk mund të përballë vetëm me këto sfida. Jo vetëm Evropa, jo vetëm Amerika. Por Evropa dhe Amerika së bashku, në NATO dhe takimi ynë sot ne do të jemi një mundësi për të adresuar se si e forcojmë këtë lidhje ndërsa përgatitemi për samitin tonë në Bruksel më vonë këtë vit. Në samit, ne do të vendosim një axhendë ambicioze transatlantike për të ardhmen, për të forcuar unitetin dhe solidaritetin tonë dhe sigurohemi që të mbetemi të fortë si si Aleancë politike dhe ushtarake, për të zgjeruar qasjen tonë ndaj



sigurisë, duke forcuar qëndrueshmërinë tonë, duke ruajtur avantazhin tonë teknologjik, duke adresuar ndikimin e sigurisë së ndryshimit të klimës dhe duke punuar më shumë së bashku dhe për të marrë një qasje më globale. Duke mbrojtur rendin ndërkombëtar

të bazuar në rregulla, i cili po sfidohet nga fuqitë autoritare si Rusia dhe Kina. Kështu që kemi shumë për të diskutuar. Sekretari Blinken, Tony, edhe një herë i mirëpritur në NATO. Ju jeni këtu jo vetëm midis aleatëve, por edhe midis miqve” Antony J. Blinken, Sekretari

i Shtetit të SHBA-së: Unë kam ardhur këtu për të shprehur angazhimin e palëkundur të Shteteve të Bashkuara për këtë Aleancë, e cila ka qenë themeli i paqes, prosperitetit, stabilitetit për komunitetin transatlantik për më shumë se 70 vjet. Unë kam ardhur në Bruksel

sel sepse Shtetet e Bashkuara duan të rindërtojnë partneritetet tona. E para dhe më e rëndësishmja, me aleatët tanë të NATO-s: Ne duam të ringjallim Aleancën, për t’u siguruar që ajo është aq e fortë dhe efektive ndaj kërcënimeve të sotme sa ka qenë në të kaluarën. Sekretari i Përgjithshëm, bisedat tona gjatë dy ditëve të ardhshme do të mbulojnë, siç e keni theksuar, një axhendë të gjerë duke përfshirë misionin e vazhdueshëm të NATO-s në Afganistan, përpjekjet tona rajonale të sigurisë, në veçanti në përgjigje të agresionit të Rusisë dhe axhendën e NATO-s 2030. Ne ndajmë vizionin e Sekretarit të Përgjithshëm për një NATO që ka aftësitë për të parandaluar dhe mbrojtur nga të gjitha mënyrat e kërcënimeve ndaj sigurisë sonë kolektive, përfshirë kërcënimet si ndryshimi i klimës dhe sulmet kibernetike. Mezi po i pres këto biseda. Unë jam përsëri mirënjohës për ju, Jens, për udhëheqjen tuaj të jashtëzakonshme të këtij institucioni, dhe unë jam shumë i lumtur që jam përsëri në NATO.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Mircea Geoană theksoi rëndësinë e ndërveprimit të fortë midis aleatëve në mënyrë që të mbajnë avantazhin teknologjik të NATO-s në Forumin e 4-të Evropian të Sigurisë Kibernetike-Parashikimi i Liderëve të Brukselit CYBERSEC-më 18 mars 2021. Në një fjalim kryesor, ai shpjegoi se NATO duhet të jetë nxitësi global i një qasje të bazuar në vlera për inovacionin e mbrojtjes, “për të siguruar që rregullat dhe normat globale të formohen nga vlerat tona-liria, demokracia, sundimi i ligjit-dhe jo nga ata që kërkojnë t’i minojnë ato”. Strategjia e re e zbatimit të NATO-s për teknologjitë në zhvillim dhe përçarje synon të nxisë zhvillimin e teknologjive të reja dhe t’i mbrojë ato nga kundërshtarët dhe konkurrentët, tha Z. Geoană. Ai nënvizoi se Kina dhe Rusia po investojnë shumë në teknologjinë e re, duke përfshirë një njoftim të fundit mbi planet për një stacion të përbashkët hulumtimi hënor. Ai më tej kujtoi se aftësia e NATO-s për të ruajtur sigurinë për gati 1 miliard njerëz është mbështetur gjithmonë në ruajtjen e avantazhit të saj teknologjik. Për të shmangur një hendek të inovacionit, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm bëri thirrje për ndërveprim më të ngushtë transatlantik dhe forcimin e punës në “spiralin e trefishtë” midis qeverisë, industrisë dhe akademisë. Ai shtoi se teknologjitë në zhvillim dhe forcimi i rezistencës do të jenë në krye të axhendës në Samitin e NATO-s në Bruksel më vonë këtë vit.

Mircea Geoana: Qasja e NATO-s ndaj teknologjive në zhvillim





Gjeneral Rama, shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë të shtetit dhe forcave italiane për rolin e tyre të madh në kuadër të misionit të KFOR-it në përgjithësi si dhe për kontributin e madh për ndërtimin, zhvillimin dhe të arriturat e deritashme të FSK-së në veçanti.



Bashkëpunimi ushtarak midis Kosovës dhe Italisë

Gjeneralallejtënant Rrahman Rama vizitë zyrtare katërditore në Itali

Në takimet përkatëse u diskutua për format e implementimit të planit të veprimit në kuadër të bashkëpunimit bilateral mes të dy forcave

Me ftesë zyrtare të homologut të tij Gjeneral Pietro Serino, komandanti i FSK-së, gjeneralallejtënant Rrahman Rama, ishte në vizitë zyrtare katërditore në Republikën e Italisë. Me këtë rast, me nderimet më të larta ushtarake, ai u prit nga autoritetet më të larta ushtarake italiane. Në takimet përkatëse u diskutua për format e implementimit të planit të veprimit në kuadër të bashkëpunimit bilateral mes të dy forcave. Nga ana e tij, gjeneral Rama, shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë të shtetit dhe forcave italiane për rolin e tyre të madh në kuadër të misionit të KFOR-it në përgjithësi si dhe për kontributin e madh për ndërtimin, zhvillimin dhe të arriturat e deritashme të FSK-së në veçanti.

Gjithashtu, gjeneral Rama i njohu me progresin e FSK-së në realizimin e Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, kapaciteteve aktuale dhe ngritjes së kapaciteteve mbrojtëse duke theksuar nevojën dhe rëndësinë e mbështetjes nga pala italiane në këtë aspekt. Me këtë rast ai, theksoi objektivin strategjik për të ndërtuar forcat ushtarake sipas standardeve më të avancuara dhe të ndërveprueshme me forcat e vendeve të NATO-s, për të qenë



të përshtatshme për operacione të përbashkëta paqeruajtëse. Nga ana e autoriteteve italiane, u vlerësuan lart të arritjet e deritashme të FSK-së, si forcë profesionale në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës si dhe në

shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë. Në fund të dy palët u pajtuan që bashkëpunimi në mes të dy forcave të thellohet dhe intensifikohet edhe më tej në fushat me interes të përbashkët.

Armend Mehaj merr detyrën si Ministër i Mbrojtjes i Kosovës

Armend Mehaj zyrtarisht pranoi detyrën e Ministrit të Mbrojtjes, më 23 mars në ambjentet e Ministrisë së Mbrojtjes, nga ana e ministrit të deritashëm, Anton Quni. Në pritjen e ministrit Mehaj dhe stafit të tij, përveç ish-ministrit Quni ishin të pranishëm edhe komandanti i FSK-së gjeneralallejtënant Rrahman Rama, sekretarja e përgjithshme e Ministrisë së Mbrojtjes, Rozafa Ukimeraj, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, general brigade Fadil Hadërgjonaj dhe zyrtarë e oficerë të tjerë të Ministrisë së Mbrojtjes. Me këtë rast, ish-ministri Quni, pasuesit të tij ministrit Mehaj i uroi shumë suksese në punën e tij duke i dorëzuar pakon e dokumenteve kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes. Kurse, nga ana e tij, ministri Mehaj vlerësoi lart punën e deritashme të ministrit Quni duke shprehur besimin se arritjet e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së do të angazhohet t'i avancojë edhe më tej, drejtë përm-bushjes së plotë të misionit kushtetues dhe ligjor. Ai ndër të tjera theksoi se kjo do të arrihet duke zhvilluar forca profesionale bazuar në standardet më të larta të ushtrive të vendeve anëtare të NATO-s, për të qenë të ndërveprueshme dhe kompatible në operacionet ndërkombëtare në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë.



UNË I PËRULEM ME SHPIRT E ZEMËR FLAMURIT KOMBËTAR

Armend Metaj, ministri i Mbrojtjes i Kosovës

Ai ka lindur në vitin 1981 në Kosovë dhe aktualisht jeton në Oslo të Norvegjisë, ku është pjesë e forcave të armatosura Norvegjeze

Armend Mehaj është emri që do të drejtojë Ministrinë e Mbrojtjes të Kosovës në qeverinë "Kurti 2". Ai ka lindur në vitin 1981 në Kosovë dhe aktualisht jeton në Oslo të Norvegjisë. Në vitin 1999 i është bashkuar forcave të armatosura Norvegjeze, për të shërbyer më pas në misione të ndryshme paqeruajtëse si në Kosovë, Irak, Afganistan, Çad dhe Afrikën Qendrore. Mehaj do të zëvendësojë në krye të ministrisë së mbrojtjes Anton Qunin, i cili u betua si deputet i Kosovës nga rradhët e LDK-së.

Në 100 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë, Kapiten Mehaj ishte dekoruar nga Shtabi i Përgjithshëm i FARSH-së, me medaljen "Për shër-



bime të veçanta, me motivacionin "Për shërbime të merituar në detyrat me përgjegjësi të lartë, si dhe në kontributin e veçantë të dhënë në përm-bushje me sukses të misionit paqeruajtës të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Çad". Me këtë rast, Mehaj kishte deklaruar se dashurinë për vendlindjen e tij Kosovën, për

Shqipërinë dhe kombin shqiptar e ka të shenjtë. "Ndjem i privilegjuar që marr këtë dekoratë në këtë 100 vjetor të Pavarësisë. Unë jam nga Kosova dhe dashurinë për vendlindjen, për Shqipërinë dhe kombin shqiptar e kam të shenjtë. Unë i përulë me shpirt e zemër flamurit kombëtar", ishte shprehur Mehaj.

Ministri Mehaj priti ambasadorin e Mbretërisë së Norvegjisë

Ministri i Mbrojtjes Armend Mehaj, aktivitetin e tij e filloi me pritjen në vizitë të ambasadorit të Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë, Jens Erik Grondahl. Me këtë rast, ministri Mehaj e falënderoi ambasadorin Grondahl për vizitën e tij duke shprehur falënderimin për Mbretërinë e Norvegjisë, për ndihmën dhe mbështetjen e ofruar në ndërtimin, zhvillimin dhe të arriturat e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Ministri Mehaj shprehu besimin e plotë se bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Norvegjisë do të intensifikohen edhe më tej në funksion të arritjes së aftësive dhe kapaciteteve të plota operacionale të FSK-së, për të mundur kështu ofrimin e kontributit të Kosovës për paqen, sigurinë dhe stabilitetin rajonal e global, në operacione paqeruajtëse krahas vendeve partnere, në mesin e të cilave me rol shumë të rëndësishëm është edhe Mbretëria e Norvegjisë. Nga ana e tij, ambasadori Grondahl e falënderoi ministrin Mehaj për pritjen dhe i uroi detyrën e re, si dhe premtoi se Norvegjia, sikur deri më tash, do të vazhdojë ta ndihmojë dhe mbështesë Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, në të gjitha fushat dhe komponentët në mënyrë që t'i përm-bushin me sukses të plotë synimet e tyre.



Marrëdhëniet e shkëlqyera midis Sllovenisë dhe Maqedonisë së Veriut u transferuan edhe në mbrojtje. “Ne tashmë kemi nënshkruar marrëveshjen për vitin 2021 dhe kemi parashikuar aktivitete që premtajn bashkëpunim dinamik, kryesisht në trajnime dhe ushtrime, stërvitje, por edhe në zhvillimin e aftësive tona të NATO-s, gjë që është me shumë rëndësi për ne”.



MINISTRJA E MBROJTJES RADMILLA SHEKERINSKA NË SLLOVENI

Sllovenia me këshillat e saj na tregoi rrugën për në NATO

Eshtë nënshkruar marrëveshja për vitin 2021 për trajnime dhe ushtrime, stërvitje, por edhe për zhvillimin e aftësive sipas standarteve të NATO-s

Ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska ka zhvilluar një vizitë zyrtare njëditore në Republikën e Sllovenisë, ku u prit me nderimet më të larta nga homologu i saj, ministri slloven i Mbrojtjes Matej Tonin. Dy ministrat patën një takim tet-a-tet që më pas vazhdoi me një takim të dy delegacioneve, ku u diskutua për bashkëpunimin dypalësh të mbrojtjes pas anëtarësimit në NATO dhe iniciativat e sigurisë rajonale.

Pas takimeve, dy ministrat dhanë deklarata për mediat në të cilat ata shprehën mbështetjen e ndërsjellë dhe theksuan planet për bashkëpunim në të ardhmen.

Marrëdhëniet e shkëlqyera midis Sllovenisë dhe Maqedonisë së Veriut u transferuan edhe në mbrojtje. “Ne tashmë kemi nënshkruar marrëveshjen për vitin 2021 dhe kemi parashikuar aktivitete që premtajn bashkëpunim dinamik, kryesisht në trajnime dhe ushtrime, stërvitje, por edhe në zhvillimin e aftësive tona të NATO-s, gjë që është me shumë rëndësi për ne,” -tha Shekerinska. Ministrja falënderoi Slloveninë për mbështetjen e saj të vazhdueshme dhe shprehu pritjen që mbështetja për fillimin e negociatave me BE-në do të jetë aq e lartë sa ishte për NATO-n.

“Për disa ditë, Zyra e NATO-s në Shkup, e cila për një kohë të gjatë ishte nën menaxhimin dhe mentorimin e Sllovenisë, do të na përshëndesë për herë të fundit me një mesazh se misioni u përfundua me sukses, Republika e Maqedonisë së Veriut u bë anëtare e NATO-s”, -tha ajo. Shekerinska tha se të dy vendet festojnë



30 vjetorin e pavarësisë këtë vit dhe uroi qytetarët slloven dhe ministrin Tonin me këtë rast. Ministri slloven i Mbrojtjes Tonin, tha se takimi ishte i suksesshëm dhe se rezultoi në një përfundim mbi mirëmbajtjen e përbashkët të automjeteve luftarake dhe pjesëmarrjen e përbashkët në misionet e NATO-s. Ministri i Mbrojtjes i Sllovenisë theksoi, siç tha ai, guximin e Qeverisë në arritjen e një kompromisi me Greqinë dhe anëtarësimin në NATO. Ai theksoi se Maqedonia

e Veriut meriton të fillojë negociatat me BE-në dhe vuri në dukje se presidenca sllovene me Unionin do ta shprehë qartë këtë pozicion. Delegacioni maqedonas në Slloveni gjithashtu vizitoi Qendrën Kombëtare për Menaxhimin e Krizave dhe u njoh me rolin dhe funksionimin e saj gjatë kohës së krizës. Shekerinska u takua me presidentin slloven Borut Pahor dhe Komisionin Parlamentar të Mbrojtjes, si dhe ka vizituar Qendrën për Luftë Malore të NATO-s.

Departamenti i Shtetit i SHBA-së

54 automjete të blinduara “STRYKER” për ushtrinë maqedonase

Prokurimi në vlerë totale rreth 210 milionë dollarë është vazhdim i projektit shumëvjeçar 2019-2024

Departamenti i Shtetit i SHBA-së ka miratuar prokurimin e 54 automjeteve të blinduara të lehta të tipit “STRYKER” për Maqedoninë e Veriut, për nevojat lidhur me modernizimin e Armatës maqedonase në përputhje me standardet e NATO-s. Prokurimi në vlerë totale prej rreth 210 milionë dollarë është vazhdim i projektit shumëvjeçar, tashmë të filluar (2019-2024), për prokurimin e Automjeteve të Lehta të Blinduara (ALB), si projekti kryesor në Planin Afatgjatë për Zhvillimin e Kapaciteteve të Mbrojtjes (PAZHKM) për modernizimin e Armatës.

Projekti zbatohet si një marrëveshje “Qeveri me Qeveri” me Qeverinë e SHBA-së dhe përfshin prokurimin nga dy kompani amerikane ushtarake me reputacion të, “Oshkosh Defense” dhe “General Dynamics Land Systems”. Prokurimi nga kompania “Oshkosh Defense” tashmë është duke u zhvilluar, dhe deri më tani kanë përfunduar të gjitha procedurat për prokurimin e rreth 40 automjeteve nga kjo kompani. Me shpalljen e vendimit të Kongresit Amerikan, për të aprovuar përfundimin e kontratës së prokurimit nga kompania “General Dynamics Land Systems”, i gjithë projekti kalon në fazën përfundimtare të kompletimit. Dorëzimi i automjeteve pritet të fillojë në vitin 2022. Realizimi i këtij projekti për pajisjen dhe modernizimin e armatës maqedonase, përveç plotësimit të kërkesave për arritjen e standarteve të NATO-s, shërben edhe për mbrojtjen e interesave jetike dhe kombëtare të Maqedonisë së Veriut. Në deklaratën e Agjencisë së Bashkëpunimit e Mbrojtjes të SHBA-së, thuhet se prokurimi i propozuar “do të përmirësojë sigurinë e aleatit të NATO-s, një forcë e rëndësishme për stabilitetin politik dhe ekonomik në Evropë, gjegjësisht do të përmirësojë kapacitetet e Maqedonisë së Veriut për t’iu përgjigjur kërcënimeve aktuale dhe të ardhshme duke rritur aftësitë operative, disponueshmërinë e forcës dhe rritjen e bashkëpunimit ushtarak”.

QENDRA E TRAJNIMIT “DR. XHOSEF KRUZEL”

Promovohet softueri i ri i sofistikuar për testimin e gjuhës angleze


Në ambientet e sapo rinovuara të Qendrës së Trajnimit “Dr. Xhosef Kruzel”, e cila është pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes, në prani të ministres Radmilla Shekerinska u promovua softueri i ri i sofistikuar dhe unik për testimin e aftësive në gjuhën angleze për të gjithë punonjësit e mbrojtjes dhe pjesëtarët e Armatës, në përputhje me standardin e NATO-s, STANAG 6001. Pas promovimit, ministrja Shekerinska tha se njohja e gjuhës angleze është një nga aftësitë që vendi duhet të garantojë si një anëtar i NATO-s, veçanërisht duke marrë parasysh që shumë oficerë, eprorë dhe ushtarë do të marrin pjesë dhe kanë marrë pjesë në operacionet e NATO-s, dhe një pjesë e tyre do të punojnë në komandat e NATO-s në qendrat e trajnimit, dmth në detyrat që nënkuptojnë një njohuri të lartë të gjuhës angleze.

“Nuk është rastësi që në Ligjin për Shërbim në Armatë, ne kemi futur një rregull

sipas të cilit çdo ngritje në detyrë nga majori e më lart do të ketë një kusht shtesë, dhe kjo është njohja më e lartë e gjuhës angleze. E gjithë kjo nuk do të përfshijë vetëm njerëzit që do të jenë zyrtarisht pjesë e aleancës së NATO-s, për sa i përket punës në komanda dhe operacione. “Ata që do të punojnë në Armatë dhe Mbrojtje çdo ditë, praktikisht një pjesë e madhe e detyrës së tyre do të jetë komunikimi me kolegët e NATO-s,” -tha ministrja. Qëllimi ynë, shtoi ajo, është të rrisim standardet, por gjithashtu të ndihmojmë të gjithë pjesëtarët e Armatës dhe punonjësit e Ministrisë për të arritur ato standarde,

përmes aftësisë për të testuar njohuritë e tyre në anglisht përmes provave demo që janë postuar në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Armatës maqedonase. “Përmes faqes së internetit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Armatës ne u japim një shans të gjithë atyre që planifikojnë të testohen për STANAG të ushtrojnë veten, të testojnë njohuritë e tyre të anglishtes dhe kur të vijmë për t’u testuar të jenë më të mirë, më të relaksuar dhe të tregojnë vërtet njohuritë e tyre në anglisht. “Me këtë ne rrisim transparencën, me këtë ne rrisim shansin për testim objektiv, por me këtë në një mënyrë u japim pjesëtarëve të Armatës dhe punonjësve

në Ministrinë e Mbrojtjes një mundësi të punojnë në vete”, -tha Shekerinska. Ministrja informoi se numri i testuar do të rritet çdo vit, veçanërisht pasi testimi aktual i letërës po zëvendësohet me elektronik, gjë që e bën këtë proces më të shpejtë dhe eliminon mundësinë e gabimit njerëzor. Ajo shtoi se këtë vit do të investohet në dy klasa shtesë në kazemat në Shtip. Standardet do të jenë më të larta, tha ministrja dhe shtoi se e gjithë kjo është bërë në mënyrë që Armatë, Ministria e Mbrojtjes dhe shteti anëtar i NATO-s të tregojnë se ne vërtet dimë se si t’i përballojmë detyrimet dhe dimë të jemi më të mirë se të tjerët.



“Të gjithë pjesëmarrësit në stërvitje meritojnë respekt,” -tha ai, duke i falënderuar ata për punën e tyre të palodhur, disiplinën, përgjegjësinë dhe dëshirën për të punuar. Shefi i Mbrojtjes vlerësoi përpjekjet e Komandës së Forcave Tokësore, komandantin i tyre, gjeneral majori Mikhail Popov dhe zëvendësin i tij gjeneral brigade Valeri Tsolov, si dhe komandantin i regjimentit 101 alpin, kolonel Dimitar Katsarov, për të siguruar që alpet tona të jenë siç duhet të pajisura dhe për të përmbushur në mënyrë adekuate standardet përkatëse.



Shefi i Mbrojtjes Admirali Emil Eftimov:

Jam i impresionuar nga aftësitë e Regjimentit 101 Alpin

Kontigjenti i 43-të, i cili do të bashkohet me misionin e NATO-s “Mbështetje e Vërtetë” në Afganistan, do të përbëhet nga ushtarakë të Regjimentit 101 Alpin dhe Regjimenti i IV i Artilerisë në Asenovgrad

“Unë jam i impresionuar nga aftësitë e Regjimentit 101 Alpin. Ushtarakët demonstuan aftësitë e tyre për të mbijetuar në kushte të rënda dimërore në disa mënyra të ndryshme, ecje në terren me dëborë malore, për të ndihmuar një viktimë të ortekut dhe kjo është një pjesë e vogël”, -tha Shefi i Mbrojtjes, Admiral Emil Eftimov, më 19 mars, pas demonstrimit të pjesëmarrësve në trajnimin e përbashkët “Rodopët-21”. “Të gjithë pjesëmarrësit në stërvitje meritojnë respekt,” -tha ai, duke i falënderuar ata për punën e tyre të palodhur, disiplinën, përgjegjësinë dhe dëshirën për të punuar. Shefi i Mbrojtjes vlerësoi përpjekjet e Komandës së Forcave Tokësore, komandantin i tyre, gjeneral majori Mikhail Popov dhe zëvendësin i tij gjeneral brigade Valeri Tsolov, si dhe komandantin i regjimentit 101 alpin, kolonel Dimitar Katsarov, për të siguruar që alpet tona të jenë siç duhet të pajisura dhe për të përmbushur në mënyrë adekuate standardet përkatëse.

Admirali Eftimov njoftoi se kontigjenti i 43-të, i cili do të bashkohet me misionin e NATO-s “Mbështetje e Vërtetë” në Afganistan, do të përbëhet nga ushtarakë të Regjimentit 101 Alpin dhe Regjimenti i IV i Artilerisë në Asenovgrad. “Së bashku me atë që ata demonstrojnë në kushtet e dimrit, ushtarakët duhet të jenë të gatshëm për të kryer një mision në një mjedis krejtësisht të ndryshëm”, -përfundoi Admirali Eftimov.

Shefi i mbrojtjes vuri në dukje se Regjimenti 101 Alpin është një shembull i rolit të trupave rreshterë, në trajnimin e ushtarakëve dhe shpjegoi se në ushtrinë profesionale kjo është një nga mënyrat për të zvogëluar ndikimin e mungesës. “Këtë vit, 85% e pozicioneve të shpal-lura të lira ushtarake do të jenë për të mbushur përbërjen e formacioneve



ushtarake të Forcave Tokësore,” -tha ai. “Rodopët-21” është pjesë e përgatitjes së Regjimentit 101 Alpin për stërvitjen ndërkombëtare “Falanga e Malit”, e cila do të mbahet në vitin 2022 në Austri dhe Itali. Qëllimi është që ushtarakët të përmirësojnë aftësitë e tyre në të shtënata, patrullimet, lëvizjet në terrene me dëborë (turne skish), mbijetesa, kërkimi dhe shpëtimi, ndihma e parë dhe evakuimi mjekësor. Ata kryejnë detyrat në kushtet e dimrit, në një lartësi prej mbi 2,000 m.

Në zonën e majës Golyam Perelik pjesëmarrësit në trajnimin e përbashkët

demonstuan aftësitë e tyre në lëvizjen me pajisje të plota luftarake në shpatet e pjerrëta me dëborë, ndërtimin e objekteve të kampeve dimërore në kushtet e dimrit (shpella e borës dhe iglo), kërkimi dhe shpëtimi i një viktime të ortekut dhe evakuimi mjekësor i viktimës. Përgatitja e përbashkët “Rodopët-21” përfundoi më 27 mars. Ai përfshinte më shumë se 240 ushtarakë nga Komanda e Forcave Tokësore, Regjimenti 101 Alpin, moduli logjistik nga Regjimenti 110 i Logjistikës, Charalitsa NVUK, si dhe përfaqësues nga Qendra e NATO-s për Kërkim, Zhvillim dhe Përmirësimin

Ushtarakët bullgarë në grupin e certifikimit “Steadfast Cobalt-21”

Grupi i Komunikimit dhe Mbështetjes së Informacionit të Modullit Kombëtar të Mobile CIS të NATO-s (DCM-F) po merr pjesë në stërvitjen vjetore të certifikimit të Aleancës, “Steadfast Cobalt-21”, në Mbretërinë e Hollandës. Kjo është një nga stërvitjet më të mëdha të udhëhequra nga Grupi CIS i NATO-s për këtë vit, me përfaqësues nga 25 vende.

Stërvitja Cobalt-21 e Qëndrueshme do të zgjasë deri në fund të Prillit dhe është krijuar për të zbatuar, certifikuar dhe vlerësuar sistemet e komunikimit dhe informacionit të Aleancës, në mënyrë që të arrihet ndërveprimi dhe të standardizohen proceset për Forcën e Përgjigjes së NATO-s të vitit të ardhshëm.

Detyra e specialistëve bullgarë nga moduli është të sigurojnë mbështetjen e komunikimit dhe informacionit (SCR) të Shtabit të Përbashkët Operacional, të caktuar për të udhëhequr Forcën e Reagimit të Shpejtë të NATO-s në 2022, si dhe të veprojnë si një grup për ndihmë në SCR për oficerët nga selia e Komandës Aleate të NATO-s që marrin pjesë në stërvitje.

Pjesa kryesore e grupit të komunikimit dhe mbështetjes së informacionit që ofron stërvitjen është në Bullgari, ndërkohë që një ekip prej shtatë ushtarakësh, i udhëhequr nga komandanti i Modullit Kombëtar, Majori Kaloyan Stoyanov, është vendosur në Hollandë.



Anija e marinës “Bodri” në stërvitjen “Mburoja e Detit”



Marina e Bullgarisë është duke marrë pjesë në stërvitjen detare rumune “Mburoja e Detit”. Anija ushtarake bullgare “Bodri”, si pjesë e flotiljes së anijeve luftarake dhe anijeve mbështetëse, u largua nga baza detare në Varna më 18 mars dhe më pas u bashkua në stërvitjen detare “Mburoja e Detit”, stërvitje me pjesëmarrje ndërkombëtare e organizuar nga Marina Rumune. Stërvitja do të vazhdojë deri në 29 mars në ujërat territoriale të Rumanisë dhe zonën ekskluzive ekonomike. Pjesëmarrja e anijes “Bodri” do të kontribuojë në për-

mirësimin e sigurisë detare dhe mbrojtjes kolektive në rajon dhe do të rrisë nivelin e trajnimit të ekuipazhit dhe ndërveprimit në një mjedis shumëkombësh. Gjatë stërvitjes, anija bullgare ka marrë pjesë në episodet e luftimit të armiqve të improvizuar të ajrit, sipërfaqes dhe nëndetës, duke luftuar rrezikun e minave, si dhe në operacionet për të kontrolluar transportin detar.

Përveç anijes bullgare “Bo-

dri” në stërvitje morën pjesë edhe anije luftarake dhe anije mbështetëse nga Marina Rumune, dy avionë patrullues detarë të SHBA-së dhe Turqisë, një anije e Marinës Greke, një helikopter dhe aeroplan luftarak nga forcat ajrore Rumune dhe Spanjolle, dhe një bateri artilerie nga Polonia. Morën pjesë edhe Forcat Tokësore Rumune dhe Grupi i Dytë i Përhershëm i Anijeve të NATO-s (SNMG-2). Anija e marinës bullgare “Bodri” do të vizitojë portin rumun të Konstancës dhe do të kthehet në Varna në 29 Mars.

Masa fortifikuese në Luftën e Shkodrës, 1912-1913



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTA

Fortifikimi i teatrit të luftimeve

Një ndër shkaqet e qëndresës së pamposhtur të forcave mbrojtëse të qytetit të Shkodrës (rreth 20.000 luftëtarë shqiptarë dhe 4.000 ushtarëve turq) gjatë rrethimit 6 mujor nga trupat e 7 divizioneve serbo-malazeze në Luftën e Parë Ballkanike, 1912-1913, sipas pjesëmarrësve në këtë luftë dhe studiuesve, ishte fortifikimi i teatrit të luftimeve. Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë turke, duke u nisur nga ideja e një lufte të mundshme me Rusinë dhe vendet ballkanike, filloi të mendojë për nevojën e një planëzimi të ri luftarak, i cili do t'i përgjigjej situatave kërcënuese që po përvijoheshin. Në fillim të vitit 1912, Shtabi madhor turk, duke parë dhe përgatitjet e Bullgarisë, Greqisë, Serbisë e Malit të Zi, përfundoi në vija të përgjithshme planëzimin luftarak.

Detyra e garnizonit osman të dislokuar në Shkodër, ishte që të mbronte me këmbëngulje dhe me çdo çmim Shkodrën dhe të pengonin suksesin ushtarak dhe politik të Malit të Zi deri në ardhjen e forcave kryesore osmane. Për këtë qëllim shtabi suprem kishte urdhëruar që Shkodra dhe Janina duhej të fortifikoheshin aq sa të ishin në gjendje që në mënyrë të pavarur (edhe në rrethim) të mbroheshin për një muaj e gjysmë. Më vonë, ky afat u zgjat deri në 6 muaj.

Fortifikimi i Shkodrës u ndërtua në përshtatje me veçoritë e terrenit malor, kodrinor, e fushor, e sidomos me pengesat e mëdha ujore, që është i pasur ky qytet si liqeni, lumenjtë Drini, Buna e Kiri. Mbi këtë bazë u ndërtua edhe sistemi i fortifikimit, i ndarë në zona. Zona e Shtojt që fillonte nga liqeni (Bishti i Qenisë) dhe përfundonte tek ura e Mesi; zona e Kirit që ishte në Bardhaj i Madh dhe i Vogël, midis lumenjve Kir dhe Drin; zona e Bërdicës midis lumenjve Drin dhe Bunë, si dhe zona e Taraboshit midis lumit Buna dhe liqenit të Shkodrës.

Punime fortifikuese solide

Krahas këtyre masave në këto zona, në murin mbrojtës (ledhet), për të penguar përmblytjet nga vërshimi lumenjve, u ndërtuan në anën e djathtë të Kirit, punime të mëdha plotësuese me qëllim që ky mur të shfrytëzohej edhe për mbrojtje. Ndërsa brenda në qytet ishin bërë punime fortifikuese në lagjet Ajazëm e Tepe (afër kalasë) e që ndodhet në lartësinë e Tepes. Fortifikata të ndërtuara me shpejtësi vitin e fundit, tashmë, ashtu siç pritej, ishin gati të përballeshin me zjarrin e luftës. Gjithçka me fortifikimin ishte gati. Forcat mbrojtëse të Shkodrës, sidomos në Bardhaj e Bërdicë, ishin të detyruara që të plotësonin boshllëqet e krijuara, të pa mbuluara me punime, duke vazhduar punimet fortifikuese edhe nën zjarrin e armikut, veçanërisht të artilerisë. Në këtë mënyrë komanda e Garnizonit të



Shkodrës mori masa që qytetin ta mbronte me një varg punimesh fortifikuese solide, duke filluar nga pjesa veriperëndimore e jugperëndimore, të mbështetur tek pengesat ujore si liqeni, lumenjtë Drini dhe Buna, mali i Taraboshit dhe lartësitë që rrethojnë Shkodrën, të cilat mbyllin pjesën më të madhe të kalimeve drejt qytetit.

Pikëmbështetjet në varësi të terrenit, kishin specifikat e tyre. Në fushë Shtojt ato ishin ndërtuar të përqëndruara në largësi të tilla (distance) për të mbyllur me forca të pakta hapësirat, ndërsa në Tarabosh, Bardhaj e Bërdicë ato ishin ndëruar në pikat dominuese të terrenit. Pozicionet e para ishin ndërtuar në (atë) mënyrë që të shfrytëzohej me efikasitet dhe maksimalisht zjarri i të gjitha armëve, pushkëve, mitralozëve dhe artilerisë. Gati të gjitha pikëmbështetjet ishin të përforcuara me pengesa teli të vendosur në atë formë që të siguronin mbrojtjen nga këmbësoria e armikut. Gjerësia e këtyre pengesave varej nga rëndësia e drejtimit. Në Bërdicë konfiguracioni dhe ekzistenca e terreneve moçalore kishte lejuar ndërtimin e gropave "thithëse" dhe llogoreve të mbushura me ujë. Duhet theksuar se, falë përparësive që jepte për mbrojtje terreni përreth Shkodrës, këto punime fortifikuese edhe pse në pjesën më të madhe ishin të karakterit fushor, kishin arritur në qëndrueshmërinë e objekteve gjysëm të përhershme.

Gjithashtu rajonet e mbrojtjes kishin një sistem të ngurtë ndërlidhjeje me telefon dhe me anë të dërgimit të sinjaleve me mjete të tjera, si dhe me korrierë. Në Tarabosh ishin instaluar disa aparate me pasqyra (taliografë) që komuniknin dhe jepnin urdhra sinjale për rajonet e tjera të mbrojtjes. Strehimet për këmbësorinë në sistemin e brendshëm të transheve e hendeclidhjeve ishin ndërtuar vetëm në pikëmbështetje, ndërsa tek të tjerat ishin të groposura në tokë. Strehimet ishin të mbuluara me llamarinë të valëzuar, me pllaka hekuri dhe me thasë me rërë, për t'u mbrojtur nga zjarri i artilerisë së kalibrit të vogël.

U ndërtuan pikëmbështetje të lidhura me transhe

Drejtimi kryesor luftarak, sipas planit

të fortifikimit të komandës së garnizonit të Shkodrës, kalonte nga bregu i majtë i Kirit në shpatet veriperëndimore të Bardhajit të Vogël, pastaj në shpatet verilindore dhe duke u kufizuar në bregun e majtë të Kirit. Nga kjo kuotë drejtimi kryesor luftarak kalonte nëpër ullishte deri në majë e më pas aty ku Bardhaj i Madh zbret në fushë.

Transhetë këtu ishin ndërtuar edhe në zonën e Shtojt sepse terreni ishte i njëjtë. Kjo ishte vija e transheve, të ndërprera, me qëndrimin në këmbë dhe me çerdhe zjarri të përforcuara me thasë me rërë dhe me dhe, ndërsa në vendet ku ishte e nevojshme me lesa të thurura. Direkt para transheve përfundonte ullishtja dhe krijohej një hapësirë rreth 400 m në të cilën nuk pengoheshin veprimet luftarake dhe sistemi i zjarrit. Pozicionet kryesore të artilerisë në Juglindje të Taraboshit të Madh ishin ndërtuar me objekte të tipit jo të përheshëm, ndërsa për pajisjet ishin ndërtuar llogore të tipit fushor, duke marrë parasysh shfrytëzimin e thasëve me rërë. Në zonën e Fushës u ndërtuan pikëmbështetje të lidhura njëra me tjetrën me transhe dhe të ndërthurura me pengesa teli me gjemba. U ndërtuan pozicione për bateritë e artilerisë. Në zonën e Malit të Taraboshit dhe kodrat e Tepes u ndërtuan pikëmbështetje togash të pajisuara me transhe, të përforcuara me

mure dhe të pajisura me hendeclidhje. U ndërtuan pika vrojtimi e pikëmbështetje, tela me gjemba. Karakteristikë ishte se pikëmbështetjet mbulonin me zjarr njera tjetrën, si dhe krahët për t'u mbrojtur nga sulmet krahëmarrëse e shpinëmarrëse. Në zonën e Bërdicës u përgatitën 4 pikëmbështetje, 2 PZ baterish, 2 pozicione për vendosjen e prozhektorëve. U ndërtuan dhe objekte prej guri ose guri dhe dheu. U ndërtuan rrugë karrocash e dekovili për transportimin e materialeve luftarake. U ndërtuan objekte për mbrojtjen e ruajtjen e ujit të pishëm si në Tarabosh dhe Fushën e Shtoit. Për fortifikimi e Shkodrës D. Tucoviç, shkruante: Llogoret e saj janë të maskuara, brenda në dhe e të ndërtuara prej betoni.

Së jashtmi nuk shihet gjë fare edhe me dylbitë më të mira. Kur fillojnë luftimet nuk dihet se nga të vjen zjarri. Janë ndërtuar një sërë pengesash të ndryshme si gropa që mbushen me ujë e të thurura me tel me gjemba që lidhen me shtylla të hekurta. E tërë fortifikata mbrohet me zjarrin e këmbësorisë, por edhe me atë të topave.

Liqeni i Shkodrës përbënte një pengesë tjetër. Nga Ura e Bunës mbrohej nga një anije e pajisur me topa e mitraloza. Kundërsulmet (daljet) nga pozicionet e fortifikuara siguronin një epërsi të madhe për forcat e garnizonit të Shkodrës.

Fortifikimi, faktor i rëndësishëm

Pajisja fortifikuese e pozicioneve të luftimit luajti rol të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e mbrojtjes. Shkodra nuk u pushtua dot me luftime, sepse faktori tepër i rëndësishëm ishte fortifikimi. Si përfundim, duhet theksuar se deri në fillim të veprimeve luftarake më 9 tetor 1912, ishin ndërtuar në përgjithësi rajonet e fortifikuara në Tarabosh, Shtojë e Bërdicë, por në asnjërën prej tyre nuk ishin përfunduar punimet e planifikuara. Zona e Kirit ishte më pak e fortifikuar, punimet në Bardhaj e Madh kishin filluar, kurse në Bardhaj e Vogël ende. Operacionet e para të ushtrisë malazeze rreth Shkodrës, i detyruan mbrojtësit e qytetit që të intesifikonin punimet fortifikuese, të cilat u përqëndruan kryesisht në zgjerimin dhe forcimin e pozicioneve të qitjes së këmbësorisë nga qëndrimi në këmbë, mjaft efikase në luftimet e zhvilluara sidomos në Shtojë e Tarabosh. Mangësitë e fortifikimit në Bardhaj të Madh e të Vogël paraqitën një rrezik të madh për qytetin edhe pse forcat kryesore të Grupimit malazez të Zetës sulmuan pikërisht në atë drejtim. Përgjatë shpateve veriore dhe jugore të Taraboshit u ndërtuan transhe të tjera, së bashku me hendeclidhjet. Meqënëse me afrimin e forcave malazeze në Muriqan rreziku më i madh vinte nga Oblika, aty u ndërtuan një brez i tërë transhesh duke u përforcuar më shumë nga ana e veriut. Krahas kësaj në anën perëndimore të Taraboshit dhe në disa kodra në jug dhe në jugperëndim të Shirokës, u ndërtuan transhe për të përforcuar mbrojtjen e kësaj ane. Në të gjithë gjatësinë e transheve në pjerrësitë e Taraboshit u vendosen pengesa me tela, me tre-katër radhë. I gjithë sistemi i fortifikimit ishte i lidhur me telefon.

Masat fortifikuese të marra me kohë, luajtën një rol të rëndësishëm dhe frenues të depërtimit të ushtrisë malazeze në Shkodër. Ky fortifikim, edhe pse i ndërtuar me shpejtësi dhe jo me të gjithë parametrat e duhur, luajti një rol vendimtar në qëndresën heroike të luftëtarëve dhe të popullatës së Shkodrës për mbrojtjen e qytetit të tyre.





SHBA i dhurojnë Forcave të Armatosura Shqiptare 29 mjete të blinduara "Humvee"

